



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 40 Akti

Nr. 77 Vendimi

Tiranë, më 15.11.2018

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Kryesuese
<b>Suela Zhegu</b>	Anëtare
<b>Pamela Qirko</b>	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, më datë 09 nëntor 2018, ora 11:30, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:**

**Z. Ramadan Troci**, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

**OBJEKTI:**

**Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:**

**Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dhe pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### **VËREN:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Z. Ramadan Troci ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe si subjekt rivlerësimi i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Ramadan Troci, duke qenë kandidat për anëtar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, në bazë të nenit 279 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi, duke u shortuar si subjekt i rivlerësimit me shortin e hedhur më datë 30.11.2017 në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

3. Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, procesi i rivlerësimit ndaj subjektit Ramadan Troci ka filluar menjëherë pasi janë caktuar me short trupat gjykues të Komisionit, si dhe është shortuar shpërndarja e çështjes konkrete më datë 30.11.2017.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues, më datë 14.12.2017, u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Genta Tafa (Bungo), u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Ramadan Troci.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Ramadan Troci, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, e veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, kishte për objekt kontrollin të figurës, verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit 84/2016, e veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, kishte për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr.84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: (1) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); (2) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe (3) grupi i punës pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua shkresa me nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2017 e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), me anë të së cilës dërgohej një raport i hollësishëm dhe i arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ramadan Troci. Në këtë raport, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt rivlerësimi, ILDKPKI-ja ka konstatuar se:

- a) deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) ka kryer deklarim të rremë;
- d) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

11. **Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*\*, datë 13.04.2018) për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Ramadan Troci.*

12. **Grupi i punës pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tre kriteret e rivlerësimit: atë të vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, më datë 11.10.2018, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tre kritere për subjektin e rivlerësimit, z. Ramadan Troci; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t`u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, më datë 15.10.2018, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes, më datë 19.10.2018 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja, më datë 29.10.2018.

16. Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

17. Z. Ramadan Troci, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, duke u përgjigjur brenda afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit.

## **III. SEANCA DËGJIMORE**

18. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, me *e-mail*, më datë 02.11.2018.

18.1. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Ramadan Troci, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, më datë 09.11.2018, ora 11:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.

18.2. Në seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë dhe i shoqëruar nga avokati i tij, z. Ardian Leka, avokat pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë.

18.3. Subjekti i rivlerësimit, z. Ramadan Troci, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

18.4. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Ramadan Troci, kërkoi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konfirmimin në detyrë.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

19. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

19.1. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19.2. Sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19.3. Sipas kreut V, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

19.4. Ndërsa, sipas kreut VI, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, procedura e vlerësimit të aftësive profesionale kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm.

19.5. Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, me nr. 2/2017<sup>[1]</sup> dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

20. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) “Deklarata e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga ana e subjektit në ILDKPKI; ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë këtij Komisioni nga DSIK-ja; (dh) raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të hartuar nga grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme; (e) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (i) denoncimet nga publiku dhe dëshmitë e marra nga ana e Komisionit; dhe (j) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërisë së burimit dhe të krijimit të saj.

Dokumentacioni i analizuar përbëhet nga:

- provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së;
- të gjitha materialet shkresore të dosjes së ardhur nga ILDKPKI-ja;

---

[1] “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr.84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

- provat e depozituara nga subjekti pranë Komisionit;
- informacionet dhe të dhënat e administruara nga ky Komision nëpërmjet organeve shtetërore, personave fizikë dhe juridikë;
- shpjegimet dhe deklaratat e subjektit në përgjigje të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni, të rezultateve të hetimit administrativ dhe shpjegimet e dhëna në seancën dëgjimore.

21.1. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklarimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë pranë ILDKPKI-së, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Ramadan Troci, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, nr. indeksi \*\*\*, më datë 25.01.2017, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI, për vitet 2003 - 2016, në raport me të dhënat e “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga bankat, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve - gjendje *cash*;
- ç) hetimeve të kryera lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti i rivlerësimit kalimtar, gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit.

➤ **NË DEKLARATËN “VETTING”, SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT DHE PERSONAT E LIDHUR ME TË KANË DEKLARUAR KËTO PASURI (TË PALUAJTSHME DHE TË LUAJTSHME):**

**22. Lloji pasurisë: apartament, me sipërfaqe 94.4 m<sup>2</sup>, ndodhur në Kashar, Tiranë, me nr. \*\*\*, ZK \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*”, kompleksi “\*\*\*\*”, shk. \*\*\*, nr. \*\*\*. Vlera e deklaruar: 5,494,080 (pesë milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e tetëdhjetë) lekë.** Pjesa në përqindje e deklaruar: 50 %.

22.1. **Burimi i krijimit të pasurisë, deklaruar në deklaratën “Vetting”:** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie, kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes së tij, për vitet 2004 deri 2011, shumën prej 2,914,080 lekësh, si edhe kredinë për blerje apartamenti të disbursuar, më datë 07.06.2011, në shumën prej 2,580,000 lekë.

22.2. **Mënyra e fitimit të pasurisë:** Pronë e fituar sipas, (1) kontratës noteriale të porosisë, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 04.03.2011, me anë të së cilës subjekti ka prenotuar këtë pasuri, apartament, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.; dhe (2) kontratës noteriale të shitblerjes, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.12.2012, me anë të së cilës, subjekti ka blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pasurinë e deklaruar.

22.3. **Deklarimet e bëra për këtë pasuri në vite:** Referuar deklaratës periodike/vjetore (në vijim DPV) të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar **blerje apartamenti, në Yzberisht, komuna Kashar, Tiranë**, sipas kontratës së porosisë së muajit shkurt 2011, kontrata e blerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.12.2011. Vlera e deklaruar e këtij apartamenti është 5,494,080 lekë. Po sipas kësaj deklaratë, subjekti ka deklaruar si burim krijimit të këtij apartamenti: (1) kursimet në vitet 2005 - 2011 të pagës së tij në vlerën prej 3,000,000 lekësh; (2) kursimet e bashkëshortes së tij nga pagat si mësuese, depozitë në “Raiffesien Bank”, në vlerën prej 700,000 lekë; (3) kredinë e marrë në Bankën Kombëtare Tregtare, në shumën 2,580,000 lekë.

### ***Hetimi i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit lidhur me këtë pasuri***

22.4. Referuar shkresës së ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë, me nr. \*\*\* prot., datë 17.01.2018, konfirmohet pasuria e regjistruar në emrin e subjektit të rivlerësimit, nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, e ndodhur në ZK \*\*\*, apartament me sipërfaqe 94.4 m<sup>2</sup>.

22.5. Në dokumentacionin që shoqëron dosjen e kësaj pasurie është administruar edhe kontrata e shitblerjes së kësaj pasurie me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.12.2012, sipas së cilës çmimi i shitjes për sipërfaqen e banimit të këtij apartamenti është në vlerën prej 5,494,080 lekë dhe ku parashikohet se kjo vlerë është paguar me këste, sipas kontratës së porosisë, jashtë zyrës noteriale.

22.6. Me deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar kontratën noteriale të porosisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 04.03.2011, të redaktuar nga noteri H.S., sipas së cilës ka porositur nga sipërmarrësi, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., ndërtimin e apartamentit, nr. \*\*\*, kati i \*\*\* i banimit, banesa “\*\*\*\*”, me sipërfaqe 109.7 m<sup>2</sup>.

22.6.1. Nëpërmjet kësaj kontrate porosie, palët kanë përcaktuar se çmimi total i shitjes së këtij apartamenti është 45,000 euro, shumë e cila do të paguhet me këste si më poshtë:

- a) kësti i parë, në shumën prej 20,000 eurosh, deklaruar si i likuiduar para lidhjes së kontratës;
- b) kësti i dytë, në shumën prej 20,000 eurosh, do të likuidohet me marrjen e kredisë për blerje banese nga “BKT”, në llogarinë bankare të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., (“BKT”, nr. i llogarisë \*\*\*);
- c) kësti i tretë dhe i fundit, në shumën prej 5,000 eurosh, do të likuidohet me marrjen në dorë të çelësave të apartamentit.

22.7. Nga verifikimi i dosjes së ardhur nga “BKT”, sipas të cilës është lidhur kontrata e kredisë bankare, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.05.2011, konfirmohet se për aplikimin dhe marrjen e kësaj kredie, ndër të tjera subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar kontratën noteriale të porosisë me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 04.03.2011.

22.8. Hetimi i kryer nga Komisioni u fokusua në të ardhurat që kanë shërbyer për kryerjen e pagesës prej 20,000 euro nga ana e subjektit të rivlerësimit, shumë e cila është likuiduar para datës 04.03.2011 (*data e lidhjes së kontratës së porosisë*).

22.8.1. Nga konvertimi me kursin mesatar vjetor të Bankës së Shqipërisë, referuar muajve shkurt - mars të vitit 2011, vlera prej 20,000 euro përlllogaritet nga ana jonë në shumën prej rreth 2,800,000 lekë<sup>1</sup>.

22.8.2. Pra, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer pagesën prej rreth 2,800,000 lekë para datës 04.03.2011, për prenotimin e kësaj pasurie të paluajtshme, për të cilat ka deklaruar se janë të ardhura nga kursimet ndër vite nga pagat subjektit dhe të bashkëshortes së tij.

### ***Analiza e të ardhurave që kanë shërbyer për kryerjen e pagesës prej 2,800,000 lekë, për blerjen e kësaj pasurie, të deklaruara nga ana e subjektit si kursime ndër vite.***

22.9. Referuar Deklaratës Fillestare të Deklarimit të Pasurive dhe Interesave Private të vitit 2003 (dorëzuar pranë ILDKPKI-së në vitin 2004), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si pasuri

---

<sup>1</sup>Konvertuar me kursin mesatar mujor (shkurt - mars 2011) të Bankës së Shqipërisë.

vetëm një autoveturë në vlerën prej 300,000 lekë. Pra, konstatohet se nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh.

### **Analiza financiare e kryer nga Komisioni, për vitin 2004**

22.10. **Referuar DPV 2004**, subjekti ka deklaruar si **shtesë pasurie**: gjendjen *cash* në shumën prej 500,000 lekë. Gjithashtu, ka deklaruar **të ardhurat** neto nga paga në shumën prej 955,764 lekë dhe të ardhurat neto nga paga e bashkëshortes së subjektit, në shumën prej 110,000 lekë.

22.11. **Të ardhurat**: Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se:

- i. referuar vërtetimit të pagës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, të ardhurat e subjektit nga paga neto për vitin 2004, janë në vlerën prej 893,167 lekë;
- ii. referuar vërtetimit të Bashkisë Bulqizë, të ardhurat neto të përfituara nga bashkëshortja e subjektit për vitin 2004 (*si mësuese*), janë në vlerën 62,244 lekë.

✓ *Konstatohet se, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me të ardhurat neto të përfituara nga paga e tij dhe e bashkëshortes së tij, për vitin 2004.*

22.11.1. Pra, rezulton se të ardhurat e ligjshme që mund të kenë shërbyer për krijimin e pasurisë, gjendjes *cash* prej 500,000 lekë në fund të vitit 2004, janë në vlerën prej **955,411 lekë**.

22.12. **Shpenzimet**: Nga ana e Komisionit, shpenzimet e kryera për vitin 2004 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në total janë përlllogaritur në shumën prej rreth 698,169 lekë.<sup>2</sup>

22.13. **Analiza financiare vjetore**: Të dhënat e analizuar më lart, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet, për vitin 2004, reflektohen në tabelën e mëposhtme:

**Tabela nr. 1 - Viti 2004.**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Viti 2004 (Vlerat në lekë)</b>
1. Gjendja e likuiditetit në fillim të periudhës 31.12.2003 <sup>3</sup>	0
2. Të ardhurat nga pagat/ subjekti dhe bashkëshortja	955,411
3. Shpenzime jetese	- 571,429
4. Shpenzime për udhëtime	- 126,740
5. Gjendja e likuiditetit në fund të periudhës 31.12.2004	500,000
<b>Diferenca e pambuluar</b>	<b>- 242,758</b>

22.14. Nga sa më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht kursimet e krijuara në vitin 2004 në vlerën 500,000 lekë.

<sup>2</sup> Këto shpenzime të llogaritura përfshijnë shpenzimet minimale për konsum familjar mesatar mujor (bazuar në përbërjen e familjes sipas certifikatës familjare) dhe shpenzimet për udhëtime bazuar në verifikimet e bëra në sistemin *TIMS* për vitin 2004.

<sup>3</sup> Gjendja e likuiditeteve *cash* është marrë në konsideratë nga Komisioni sipas vetëdeklarimeve të subjektit të rivlerësimit të bërë në deklaratat periodike/vjetore.



Si rrjedhim arrijmë në konkluzionin se, në rastin më të mirë, subjekti ka pasur mundësi të kursejë për vitin 2004 shumën *cash* prej rreth 257,000 lekë.

### ***Analiza financiare e kryer nga Komisioni, për vitin 2005***

22.15. **Referuar DPV 2005**, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si **shtesë pasurie**: (1) gjendjen *cash* në shumën prej 500,000 lekësh, 100 % në emrin e tij; dhe (2) shumën prej 170,000 lekë gjendje depozite në “Raiffeisen Bank”, depozituar nga bashkëshortja e subjektit. Gjithashtu, ka deklaruar **të ardhurat** neto nga paga në shumën prej 970,900 lekë dhe të ardhurat neto nga paga e bashkëshortes së subjektit, në shumën prej 225,800 lekë.

22.16. **Të ardhurat**: Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se:

- i. referuar vërtetimit të pagës të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, të ardhurat neto të përfituara nga paga e subjektit për vitin 2005, janë në vlerën prej 970,900 lekë;
- ii. referuar vërtetimit të Bashkisë Bulqizë, të ardhurat neto të përfituara nga bashkëshortja e subjektit për vitin 2005 (*si mësuese*) janë në vlerën prej 200,702 lekë.

✓ *Konstatohet se, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me të ardhurat neto të përfituara nga paga e bashkëshortes së subjektit, për vitin 2005.*

22.16.1. Sa më sipër, rezulton se të ardhurat e ligjshme të përfituara gjatë këtij viti që mund të kenë shërbyer për krijimin e pasurisë, gjendjes *cash* prej 500,000 lekë dhe gjendjes së depozitës prej 180,000 lekë në fund të vitit 2005, janë në vlerën prej 1,171,602 lekë.

22.17. **Analiza e gjendjeve të llogarive bankare**: Nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij në “Raiffeisen Bank”, konstatohet se:

- i. gjendja e llogarisë rrjedhëse e subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, më datë 31.12.2005, është në vlerën 162,642 lekë, ndërsa e bashkëshortes së subjektit është në vlerën prej 40,895 lekë;
- ii. gjendja e llogarisë depozitë, në emër të bashkëshortes së subjektit, më datë 31.12.2005, është në vlerën prej 179,743 lekë.

✓ *Konstatohet se, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me vlerën e depozitës në emër të bashkëshortes, si edhe nuk ka deklaruar si shtesa pasurie gjendjet e llogarive rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në emrin e tij dhe të bashkëshortes.*

22.18. **Evidentimi përfundimtar i shtesave të pasurisë për vitin 2005**: Nga analiza e të dhënave të mësipërme, sipas vetëdeklarimit dhe konstatimeve të bëra nga ana jonë bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë shtuar pasurinë neto për vitin 2005, si më poshtë:

- i. gjendje *cash*, vlera prej 500,000 lekësh;
  - ii. gjendje depozite, në emër të bashkëshortes së subjektit, vlera prej 179,743 lekë;
  - iii. gjendje llogarie rrjedhëse, e subjektit të rivlerësimit, vlera prej 162,642 lekë;
  - iv. gjendje llogarie rrjedhëse, në emër të bashkëshortes, vlera prej 40,895 lekë;
- Totali pasurisë së shtuar nga ana subjektit për vitin 2005, vlera prej 883,280 lekë.

22.19. **Shpenzimet:** Nga ana e Komisionit, shpenzimet e kryera për vitin 2005 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në total janë përlogaritur në shumën prej rreth 693,969 lekë.<sup>4</sup>

22.20. Nga diferenca e bërë midis të ardhurave neto të përfituara nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së subjektit për vitin 2005, me shpenzimet e përlogaritura nga ana jonë, konstatohet se të ardhurat e mundshme të ligjshme për krijimin e pasurisë (*gjendjes së likuiditeteve cash dhe në sistemin bankar*) janë në vlerën prej 477,633 lekë.

22.21. Sa më sipër, nga diferenca e bërë midis vlerës së pasurisë së shtuar (*likuiditeteve*) dhe të ardhurave të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie konstatohet se, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shtesën e likuiditeteve përgjatë vitit 2005, në vlerën prej rreth 406,000 lekë.

22.22. **Analiza financiare vjetore:** Të dhënat e analizuara më lart, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2005, reflektohen në tabelën e mëposhtme:

**Tabela nr. 2 - Viti 2005.**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Viti 2005 (Vlerat në lekë)</b>
1. Gjendja e likuiditetit në fillim të periudhës 31.12.2004 <sup>5</sup>	500,000
2. Të ardhurat nga pagat/ subjekti dhe bashkëshortja	1,171,602
3. Shpenzime jetese	- 571,429
4. Shpenzime për udhëtime	- 122,540
5. Gjendja e likuiditetit në fund të periudhës 31.12.2005 <sup>6</sup>	1,383,280
<b>Diferenca e pambuluar</b>	<b>- 405,647</b>

22.23. Nga sa më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht kursimet e krijuara në vitin 2005, likuiditetet *cash* në vlerën 500,000 lekë, gjendjet e llogarive rrjedhëse bankare në “Raiffeisen Bank” në total në vlerën prej 203,537 lekë dhe të depozitës prej 180,000 lekë në emër të bashkëshortes së subjektit, në “Raiffeisen Bank”. Si rrjedhim arrijmë në konkluzionin se, në rastin më të mirë, subjekti ka pasur mundësi të kursejë për vitin 2005, krahas shtesave të likuiditeteve të vetëdeklaruara si depozitë dhe ato në llogaritë rrjedhëse të evidentuara nga ana jonë, shumën *cash* prej rreth 95,000 lekë.

#### **Analiza financiare e kryer nga Komisioni, për vitin 2006**

22.24. **Referuar DPV 2006,** subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si **shtesë pasurie:** (1) gjendjen *cash* në shumën prej 400,000 lekë, 100% në emrin e tij; dhe (2) depozitë në “Raiffeisen Bank”, nga paga e bashkëshortes së subjektit, shumën prej 190,000 lekë. Gjithashtu, ka deklaruar **të**

<sup>4</sup> Këto shpenzime të llogaritura përfshijnë shpenzimet minimale për konsum familjar mesatar mujor (bazuar në përbërjen e familjes sipas certifikatës familjare) dhe shpenzime për udhëtime bazuar në verifikimet e bëra në sistemin *TIMS* për vitin 2005.

<sup>5</sup> Sipas vetëdeklarimit.

<sup>6</sup> Përfshin kursimet *cash* sipas vetëdeklarimit dhe gjendjet e llogarive bankare, sipas dokumentacionit.

**ardhurat** neto nga paga në vlerën prej 899,510 lekë dhe të ardhurat neto nga paga e bashkëshortes së tij, në vlerën prej 293,832 lekë.

22.25. **Të ardhurat:** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstatohet se:

- i. referuar vërtetimit të pagës të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, të ardhurat neto nga paga e subjektit për vitin 2006, janë në vlerën prej 877,962 lekë;
- ii. referuar vërtetimit të Bashkisë Bulqizë, të ardhurat neto nga paga të përfituara nga bashkëshortja e subjektit (*si mësuese*) për vitin 2006, janë në vlerën prej 221,907 lekë.

✓ *Konstatohet se, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me të ardhurat neto të përfituara nga paga e tij dhe bashkëshortes, për vitin 2006.*

22.26. **Analiza e gjendjeve të llogarive bankare:** Nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së subjektit konstatohet se, gjendja e llogarisë rrjedhëse e subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, më datë 31.12.2006, është 70,132 lekë, ndërsa e bashkëshortes së subjektit është në vlerën prej 13,189 lekë. Nga verifikimi i llogarisë depozitë në emër të bashkëshortes së subjektit, konfirmohet shtesa prej 190,000 lekë, nga vetëdeklarimi i mëparshëm.

22.26.1. Duke qenë se, siç e kemi evidentuar edhe më lart, gjendja e llogarive bankare (*llogaria e subjektit dhe bashkëshortes së subjektit*), më datë 31.01.2005, është në total në vlerën prej 203,537 lekë, nga ana jonë shuma prej 120,216 lekë (*diferenca mes gjendjes së llogarive, më datë 31.12.2005, me gjendjet e llogarive rrjedhëse, më datë 31.12.2006*), do të merret e mirëqenë si e ardhur që mund të ketë shërbyer për krijimin e pasurisë së subjektit për vitin 2006, shtesat e pasurive për këtë vit.

✓ *Konstatohet se, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si pakësim pasurie gjendjet e llogarive rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në emrin e tij dhe të bashkëshortes.*

22.27. Sa më sipër, rezulton se të ardhurat e ligjshme të përfituara dhe të disponueshme gjatë vitit 2006 që mund të kenë shërbyer për krijimin e pasurisë, gjendjes *cash* prej 400,000 lekë dhe shumës prej 190,000 lekë të depozituara në “Raiffeisen Bank”, në fund të këtij viti, janë në vlerën prej 1,220,085 lekë.

22.28. **Shpenzimet:** Nga ana e Komisionit, shpenzimet e kryera për vitin 2006 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat të lidhur me të, janë përlllogaritur në total në shumën prej rreth 695,132 lekë.<sup>7</sup>

22.29. **Analiza financiare vjetore:** Të dhënat e analizuara më lart, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet, për vitin 2006, reflektohen në tabelën e mëposhtme:

**Tabela nr. 3 - Viti 2006.**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Viti 2006 (Vlerat në lekë)</b>
1. Gjendja e likuiditetit në fillim të periudhës 31.12.2005 <sup>8</sup>	1,383,537

<sup>7</sup> Këto shpenzime të llogaritura përfshijnë shpenzimet minimale për konsum familjar mesatar mujor (bazuar në përbërjen e familjes sipas certifikatës familjare) dhe shpenzime për udhëtime bazuar në verifikimet e bëra në sistemin *TIMS* për vitin 2006.

<sup>8</sup> Përfshin kursimet *cash* sipas vetëdeklarimit dhe gjendjet e llogarive bankare, sipas dokumentacionit.

2. Të ardhurat nga pagat/ subjekti dhe bashkëshortja	1,120,104
3. Shpenzime jetese	- 571,429
4. Shpenzime për udhëtime	- 123,703
5. Gjendja e likuiditetit në fund të periudhës 31.12.2006 <sup>9</sup>	1,853,321
<b>Diferenca e pambuluar</b>	<b>- 44,812</b>

22.30. Nga sa më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht kursimet e krijuara në vitin 2006, në vlerën prej 400,000 lekë, apo shtesën në depozitën në “Raiffeisen Bank”, në emër të bashkëshortes së subjektit, në vlerën prej 190,000 lekë. Si rrjedhim arrijmë në konkluzionin se, në rastin më të mirë, subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të kursejë për vitin 2006, shumën *cash* prej rreth 355,000 lekë.

### ***Analiza financiare e kryer nga Komisioni, për vitin 2007***

22.31. **Referuar DPV 2007**, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar **si shtesë pasurie: (1) gjendjen *cash* në shumën prej 400,000 lekë** nga shitja e automjetit me targë \*\*\*, 100 % në emrin e tij; dhe **(2) kursime nga paga e tij si prokuror, shumën prej 600,000 lekë**, 100% në emrin e tij.

Gjithashtu, ka deklaruar **të ardhurat** neto nga paga në shumën prej 1,020,352 lekë dhe të ardhurat neto nga paga e bashkëshortes së subjektit, në shumën prej 290,800 lekë.

22.32. **Të ardhurat:** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se:

- i. referuar vërtetimit të pagës të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, të ardhurat e subjektit nga paga neto për vitin 2007, janë në vlerën prej 1,023,731 lekë.
- ii. referuar vërtetimit të Bashkisë Bulqizë, të ardhurat neto nga paga të përfituara nga bashkëshortja e subjektit për vitin 2007 (*si mësuese*), janë në vlerën 81,602 lekë. Për periudhën 09.04.2007 - 30.11.2007 konstatohet se, bashkëshortja e subjektit ka qenë me raport lindjeje. Për këtë arsye u verifikua informacioni i marrë nga “Raiffeisen Bank”, sipas të cilit rezultoi se të ardhurat nga paga dhe nga raporti i lindjes për bashkëshorten e subjektit për vitin 2007, janë në total në vlerën prej 198,855 lekë;
- iii. të ardhura nga shitja e makinës, në shumën 400,000 lekë.

✓ *Konstatohet se, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me të ardhurat neto të përfituara nga paga e bashkëshortes së subjektit, për vitin 2007.*

22.32.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konfirmohet se, me anë të kontratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.06.2007, subjekti ka shitur automjetin, tip “Mercedes-Benz”, për vlerën prej 400,000 lekë.

22.32.2. Sa më sipër, rezultoi se totali i të ardhurave të ligjshme të përfituara gjatë vitit 2007 që mund të kenë shërbyer për krijimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit në fund të këtij viti, janë në vlerën prej 1,622,586 lekë.

<sup>9</sup> Përfshin kursimet *cash* sipas vetëdeklarimit dhe gjendjet e llogarive bankare, sipas dokumentacionit.

22.33. **Analiza e gjendjeve të llogarive:** Sikurse e kemi evidentuar edhe më sipër, gjendjet e llogarive bankare në “Raiffeisen Bank” (*llogarisë së subjektit dhe bashkëshortes së tij*), më datë 31.12.2006, janë në total në vlerën prej 83,321 lekë. Gjendja e llogarisë rrjedhëse e subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank”, më datë 31.12.2007, është në vlerën prej 338,174 lekë, ndërsa e llogarisë rrjedhëse të bashkëshortes së tij është në vlerën prej 77,903 lekë. Rezulton se, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë shtuar në llogaritë rrjedhëse, në total vlerën prej 332,756 lekë (*diferenca e gjendjes së llogarive, më datë 31.12.2007, më 31.12.2006*).

✓ *Konstatohet se, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si shtesë pasurie gjendjet e llogarive rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, në emrin e tij dhe të bashkëshortes së tij.*

22.33.1. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit bankar rezulton se depozita e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank” është shtuar me shumën 60,000 lekë për vitin 2007.

✓ *Konstatohet se, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar si shtesë pasurie shumën prej 60,000 lekë,, të shtuar në depozitën në “Raiffeisen Bank”, në emër të bashkëshortes së tij.*

22.34. **Evidentimi përfundimtar i shtesave të pasurisë për vitin 2007:** Nga analiza e të dhënave të mësipërme, sipas vetëdeklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe konstatimeve të bëra nga ana jonë bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, rezulton se, subjekti dhe bashkëshortja e subjektit kanë shtuar vlerën e pasurisë neto për vitin 2007, si më poshtë:

- i. vlera prej 1,000,000 lekë (*shitja e automjetit + kursime*);
- ii. shtuar në depozitën, në emër të bashkëshortes, vlera prej 60,000 lekë;
- iii. shtuar gjendja e llogarive rrjedhëse në vlerën prej 332,756 lekë;
  - Totali pasurisë së shtuar për vitin 2007, vlera prej 1,392,756 lekë.

22.35. **Shpenzimet:** Nga ana e Komisionit, shpenzimet e kryera për vitin 2007 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë përlllogaritur në total në shumën prej rreth 571,429 lekë.<sup>10</sup>

22.36. Nga diferenca e bërë midis të ardhurave neto të përfituara nga ana e subjektit dhe bashkëshortes së tij për vitin 2007, likuiditetet e evidentuara nga ana jonë si gjendje në llogaritë rrjedhëse më datë 31.12.2006, si edhe të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit, me shpenzimet e përlllogaritura nga ana jonë, konstatohet se të ardhurat e mundshme të ligjshme për krijimin e pasurisë (*gjendjes së likuiditeteve cash dhe në sistemin bankar*) janë në vlerën prej 1,134,478 lekë.

22.37. Për sa më sipër, nga diferenca e bërë midis vlerës së pasurisë së shtuar (*likuiditeteve*) dhe të ardhurave të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për të justifikuar shtesën e likuiditeteve përgjatë vitit 2007, në vlerën prej rreth 340,000 lekë.

22.38. **Analiza financiare vjetore:** Të dhënat e analizuara më lart, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për vitin 2007, reflektohen në tabelën e mëposhtme:

---

<sup>10</sup> Këto shpenzime të llogaritura për këtë vit përfshijnë vetëm shpenzimet minimale për konsum familjar, mesatar mujor (bazuar në përbërjen e familjes sipas certifikatës familjare).

**Tabela nr. 4 - Viti 2007**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Viti 2007 (Vlerat në lekë)</b>
1. Gjendja e likuiditetit në fillim të periudhës 31.12.2006 <sup>11</sup>	1,853,321
2. Të ardhurat nga pagat/ subjekti dhe bashkëshortja	1,222,586
3. Të ardhura nga shitja e makinës	400,000
4. Shpenzime jetese	- 571,429
5. Gjendja e likuiditetit në fund të periudhës 31.12.2007 <sup>12</sup>	3,246,077
<b>Diferenca e pambuluar</b>	<b>- 341,599</b>

22.39. **Nga sa më sipër, konstatohet se** subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht kursimet e deklaruara në DPV 2007, për rrjedhojë, arrijmë në konkluzionin se, në rastin më të mirë, subjekti ka pasur mundësi të kursejë për vitin 2007 shumën *cash* prej rreth 260,000 lekë dhe jo vlerën prej 600,000 lekë, të vetëdeklaruar në DPV 2007.

***Analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2008***

22.40. **Referuar DPV 2008**, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si shtesë pasurie automjetin tip “Mercedes-Benz”, viti i prodhimit 1999, me targë \*\*\*, me vlerë 700,000 lekë.

22.41. **Burimi i krijimit:** Si burim të krijimit ka deklaruar të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Pjesa në përqindje, deklaruar 100 % në emrin e tij.

22.42. **Të ardhurat:** Referuar DPV 2008 konstatohet se, subjekti ka deklaruar të ardhurat neto nga paga në shumën prej 1,281,786 lekë dhe të ardhurat neto nga paga e bashkëshortes së subjektit, në shumën prej 354,235 lekë.

22.42.1. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstatohet se:

- i. referuar vërtetimit të pagës të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, të ardhurat neto nga paga të subjektit për vitin 2008, janë në vlerën prej 970,834 lekë;
- ii. referuar vërtetimit të Drejtorisë Arsimore Bulqizë, të ardhurat neto nga paga të përfituara nga bashkëshortja e subjektit për vitin 2008, janë në vlerën 192,523 lekë.

✓ *Konstatohet se, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë lidhur me të ardhurat neto të përfituara nga paga e tij dhe e bashkëshortes.*

22.42.2. Trupi gjykues vëren se, paraprakisht në analizën e të ardhurave të bëra për këtë vit, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit i janë llogaritur si të ardhura vjetore neto shuma prej 397,749 lekë. Kjo shumë përfaqëson shumën totale të kreditimeve të bëra në llogarinë e pagës së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit për vitin 2009 (jo për vitin 2008) dhe se gabimisht (*nisur*

<sup>11</sup> Përfshin kursimet *cash* sipas vetëdeklarimit dhe gjendjet e llogarive bankare, sipas dokumentacionit.

<sup>12</sup> Përfshin kursimet *cash* sipas vetëdeklarimit dhe gjendjet e llogarive bankare, sipas dokumentacionit.

nga diferenca mes deklarimit të subjektit dhe vërtetimit të dorëzuar për të ardhurat e bashkëshortes për vitin 2008 si edhe nisur nga vlera e përafërt e kësaj shume me vetëdeklarimin e bërë në këtë DPV), është llogaritur si shumë e të ardhurave neto të përfituara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit për vitin 2008.<sup>13</sup>

22.42.3. Nga analiza financiare e bërë, duke llogaritur si të ardhura të përfituara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit për vitin 2008 shumën 397,749 lekë ka rezultuar se, diferenca e pambuluar për shtesën e aseteve përgjatë këtij viti është në shumën prej rreth 350,000 lekë. Në rezultatet e hetimit, subjektit i është paraqitur tabela me analizën financiare vjetore që pasqyron këtë rezultat.

22.42.4. Nisur nga sa më sipër, Komisioni vlerëson se, totali i të ardhurave të ligjshme të përfituara gjatë vitit 2008 që mund të kenë shërbyer për krijimin e pasurive të subjektit përgjatë këtij viti, janë në vlerën prej 1,163,357 lekë.

22.43. **Shpenzimet:** Nga ana e Komisionit, shpenzimet e kryera për vitin 2008 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë përllogaritur në total në shumën prej rreth 917,572 lekë.<sup>14</sup>

22.44. **Analiza e gjendjeve të llogarive:** Sikurse e kemi evidentuar edhe më sipër, gjendjet e llogarive rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”, të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, më datë 31.12.2007, janë në total në vlerën prej 416,077 lekë (338,174 lekë gjendja e llogarisë së subjektit dhe 77,903 lekë gjendja e llogarisë rrjedhëse së bashkëshortes së tij). Ndërsa, gjendja e llogarisë rrjedhëse së subjektit në “Raiffeisen Bank”, më datë 31.12.2008, është në vlerën prej 330,052 lekë, ndërsa e llogarisë rrjedhëse të bashkëshortes së subjektit është në vlerën prej 97,643 lekë. Pra, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e subjektit kanë shtuar në llogaritë rrjedhëse në total vlerën prej 11,618 lekë (diferenca e gjendjes së llogarive, më datë 31.12.2008 me datën 31.12.2007), duke shtuar pasurinë për vitin 2008 edhe me vlerën prej 11,618 lekë.

22.44.1. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit bankar konstatohet se, depozita në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit është shtuar me vlerën prej 89,700 lekë.

✓ Konstatohet se, subjekti nuk ka deklaruar si shtesë pasurie shumën prej 89,700 lekësh (80,000 lekë depozituar në këtë vit dhe 9,700 lekë interesa të përfituara) të shtuar në depozitën në “Raiffeisen Bank”, në emër të bashkëshortes së tij.

22.45. **Evidentimi përfundimtar i shtesave të pasurisë për vitin 2008:** Nga analiza e të dhënave të mësipërme, sipas vetëdeklarimit të subjektit të rivlerësimit dhe konstatimeve të bëra nga ana jonë bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, rezulton se subjekti dhe bashkëshortja e subjektit kanë shtuar pasurinë neto për vitin 2008, si më poshtë:

- i. automjet tip “Mercedes-Benz”, vlera prej 700,000 lekë;
  - ii. shtesë në llogarinë depozite, në emër të bashkëshortes së subjektit, vlera prej 89,700 lekë;
  - iii. gjendjet e llogarive rrjedhëse, shtuar vlera prej 11,618 lekë;
- Totali pasurisë së shtuar për vitin 2008, vlera prej 801,318 lekë.

<sup>13</sup> Kjo pasaktësi ka ardhur edhe si rezultat i vullnetit për të kryer një hetim sa më të drejtë dhe objektiv nga ana e këtij Komisioni, fakt ky i provuar nga analiza financiare e vitit 2007. Sikurse kemi pasqyruar në analizën financiare të vitit 2007, të ardhurat e llogaritura të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit janë më të larta nga ato të pasqyruara në vërtetimin e Bashkisë Bulqizë, pasi nuk pasqyroheshin të ardhurat e përfituara nga sigurimet shoqërore për efekt të lejes së lindjes.

<sup>14</sup> Këto shpenzime të llogaritura përfshijnë shpenzimet minimale për konsum familjar mesatar mujor (bazuar në përbërjen e familjes sipas certifikatës familjare) dhe shpenzime për udhëtime bazuar në verifikimet e bëra në sistemin TMS për vitin 2008.

22.46. **Analiza përmbledhëse financiare vjetore:** Nga diferenca e bërë midis të ardhurave neto të përfituara nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së subjektit për vitin 2008, me shpenzimet e përlogaritura nga ana jonë rezultojnë se, të ardhurat e mundshme të ligjshme për krijimin e pasurisë, shtesave të pasurisë në vitin 2008, janë në vlerën prej 451,012 lekë.

22.46.1. Për sa më sipër, nga diferenca e bërë midis vlerës së pasurisë së shtuar (*automjetit tip “Mercedes - Benz” + shtesën e gjendjes së llogarive bankare dhe depozitës*) dhe të ardhurave të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie konstatohet se, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për të justifikuar shtesën e likuiditeteve dhe blerjen e automjetit përgjatë vitit 2008, në vlerën prej rreth 555,000 lekë.

22.47. Të dhënat e analizuara më lart, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të për vitin 2008, reflektohen në tabelën e mëposhtme:

**Tabela nr. 5 - Viti 2008**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Viti 2008 (Vlerat në lekë)</b>
1. Gjendja e likuiditetit në fillim të periudhës 31.12.2007 <sup>15</sup>	3,246,077
2. Autoveturë tip “Mercedes-Benz”, me targë ***	- 700,000
3. Të ardhurat nga pagat/ subjekti dhe bashkëshortja	1,163,357
4. Shpenzime jetese	- 571,429
5. Shpenzime për udhëtime	- 346,143
6. Gjendja e likuiditetit në fund të periudhës 31.12.2007 <sup>16</sup>	3,347,395
<b>Diferenca e pambuluar</b>	<b>- 555,533</b>

22.48. Për sa më sipër, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shtesën e asetëve përgjatë vitit 2008 (*blerjen e automjetit tip “Mercedes - Benz” dhe shtesën e likuiditeteve, llogaritë rrjedhëse dhe depozitës*).

**Analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2009**

22.49. **Referuar DPV 2009**, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si **shtesë pasurie**: (1) gjendjen *cash* në shumën prej 500,000 lekë, 100% në emrin e tij; dhe (2) shtuar depozita në “Raiffeisen Bank”, nga paga e bashkëshortes së tij, në shumën prej 180,000 lekë. Gjithashtu, ka deklaruar **të ardhurat** neto nga paga në shumën prej 1,062,065 lekë dhe të ardhurat neto nga paga e bashkëshortes së tij në shumën prej 397,749 lekë.

22.50. **Analiza e të ardhurave:** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstatohet se:

- i. referuar vërtetimit të pagës të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibrë, të ardhurat e subjektit nga paga neto për vitin 2009, janë në vlerën prej 1,081,532 lekë;

<sup>15</sup> Përfshin kursimet *cash* sipas vetëdeklarimit dhe gjendjet e llogarive bankare, sipas dokumentacionit.

<sup>16</sup> Përfshin kursimet *cash* sipas vetëdeklarimit dhe gjendjet e llogarive bankare, sipas dokumentacionit.



ii. referuar vërtetimit të Drejtorisë Arsimore Dibër, të ardhurat neto të përfituara nga bashkëshortja e subjektit për vitin 2009, janë në vlerën prej 284,824 lekë.

✓ *Konstatohet se, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me të ardhurat neto të përfituara nga paga e tij dhe e bashkëshortes së subjektit për vitin 2009.*

22.50.1. Për sa më sipër, konstatohet se të ardhurat e ligjshme të përfituara gjatë vitit 2009 që mund të kenë shërbyer për krijimin e pasurisë, shtesën e likuiditeteve, në fund të këtij viti, janë në vlerën prej 1,366,356 lekësh.

22.51. **Shpenzimet:** Nga ana e Komisionit, shpenzimet e kryera për vitin 2009 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë përllogaritur në total në shumën prej rreth 781, 299 lekë<sup>17</sup>.

22.52. **Analiza e gjendjeve të llogarive:** Gjendja e llogarisë rrjedhëse të subjektit në “Raiffeisen Bank”, më datë 31.12.2009, është në vlerën prej 36,428 lekë, ndërsa e bashkëshortes së subjektit është në vlerën prej 193,983 lekë. Ndërkohë, gjendja e llogarisë rrjedhëse e subjektit në “Raiffeisen Bank”, më datë 31.12.2008, është në vlerën prej 330,052 lekë, ndërsa e llogarisë rrjedhëse të bashkëshortes së subjektit, është në vlerën prej 97,643 lekë.

✓ *Konstatohet se përgjatë vitit 2009, subjekti ka pakësuar gjendjet e llogarive rrjedhëse (të tijën dhe të bashkëshortes së tij). Por, sikurse nuk ka deklaruar si shtesë pasurie gjendjet e këtyre llogarive, po ashtu nuk ka deklaruar dhe pakësimin e tyre.*

22.52.1. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit bankar rezulton se, *depozita në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit është shtuar me vlerën 210,000 lekë.*

✓ *Konstatohet se, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me vlerën e shtuar të depozitës në emër të bashkëshortes.*

22.53. **Analiza financiare vjetore:** Të dhënat e analizuara më lart, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2009, reflektohen në tabelën e mëposhtme:

**Tabela nr. 6 - Viti 2009.**

Përshkrimi	Viti 2009 (Vlerat në lekë)
1. Gjendja e likuiditetit në fillim të periudhës 31.12.2008 <sup>18</sup>	3,347,395
2. Të ardhurat nga pagat/ subjekti dhe bashkëshortja	1,366,356
3. Shpenzime jetese	- 571,429
4. Shpenzime për udhëtime	- 209,870
5. Gjendja e likuiditetit në fund të periudhës 31.12.2009 <sup>19</sup>	3,860,378
<b>Diferenca e mbetur për shpenzime të tjera</b>	<b>72,074</b>

<sup>17</sup> Këto shpenzime të llogaritura përfshijnë shpenzimet minimale për konsum familjar mesatar mujor (bazuar në përbërjen e familjes sipas certifikatës familjare) dhe shpenzime për udhëtime bazuar në verifikimet e bëra në sistemin TIMS për vitin 2009.

<sup>18</sup> Përfshin kursimet *cash* sipas vetëdeklarimit dhe gjendjet e llogarive bankare, sipas dokumentacionit.

<sup>19</sup> Përfshin kursimet *cash* sipas vetëdeklarimit dhe gjendjet e llogarive bankare, sipas dokumentacionit.

22.54. Nga sa më sipër, konstatohet se subjekti ka burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shtesën e asetëve (*likuiditete cash dhe brenda sistemit bankar*) dhe shpenzimet e realizuara në vitin 2009.

### ***Analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2010***

22.55. **Referuar DPV 2010**, subjekti ka deklaruar si **shtesë pasurie**: (1) gjendjen *cash* në shumën prej 500,000 lekë, deklaruar 100 % në emrin e tij; (2) shtesë depozite në “Raiffeisen Bank” nga paga e bashkëshortes së subjektit, shumën prej 257,198 lekë; dhe (3) kursime nga paga e vëllait të tij, në vlerën prej 200,000 lekë. Gjithashtu, ka deklaruar **të ardhurat** neto nga paga e tij në shumën prej 1,131,147 lekë, të ardhurat neto nga paga e bashkëshortes së subjektit, në shumën prej 395,749 lekë, si edhe të ardhurat neto nga paga e të vëllait si punonjës pranë market “\*\*\*\*”, në vlerën prej 480,000 lekë.

22.56. **Analiza e të ardhurave**: Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, konstatohet se:

- i. referuar vërtetimit të pagës të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, të ardhurat neto nga paga e subjektit për vitin 2010, janë në vlerën prej 1,055,485 lekë;
- ii. referuar vërtetimit të Drejtorisë Arsimore Dibër, të ardhurat neto të përfituara nga bashkëshortja e subjektit për vitin 2010, janë në vlerën prej 107,898 lekë. Ndërsa nga verifikimi i llogarisë bankare të bashkëshortes së subjektit në “Raiffeisen Bank” rezulton se, referuar kreditimeve për vitin 2010, të ardhurat nga paga e shpërblime janë në total në vlerën prej rreth 257,199 lekë;
- iii. subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues lidhur me të ardhurat e vëllait të tij.

#### **→ Konstatohet se:**

- subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me të ardhurat neto të përfituara nga paga e tij dhe e bashkëshortes për vitin 2010;
- ka kryer deklarim të pasaktë, duke deklaruar vlerën prej 480,000 lekë, si të ardhura të vëllait të subjektit, të përfituara nga puna pranë market “\*\*\*\*”, si edhe shtesën prej 200,000 lekë si kursime të vëllait të subjektit.

22.56.1. Nga ana jonë, fillimisht u evidentua se market “\*\*\*\*”, ku pretendohet se ka punuar vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. A.T., është subjekti tregtar “\*\*\*\*”, person fizik, me NIPT \*\*\*, i regjistruar si tatimpagues në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë.

22.56.2. Në vijim të veprimeve verifikuese hetimore, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.02.2018, i jemi drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, duke i kërkuar të dhëna të punësimit dhe të ardhurat bruto dhe neto për vitet 2010 - 2011 për shtetasin A.T., si edhe nëse ky shtetas figuron si i punësuar pranë këtij subjekti tregtar për periudhën në fjalë.

22.56.3. Pas administrimit të shkresës “*kthim përgjigje*” të Degës së Arkivit pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, jemi informuar se nga kontrolli i dokumentacionit që ata disponojnë për subjektin “\*\*\*\*”, me NIPT \*\*\*, rezulton se:

- i. për periudhën janar - dhjetor 2010, nuk administrojnë listëpagesa;
- ii. për periudhën janar - dhjetor 2011, emri (A.T.) nuk figuron në listëpagesa.

22.56.4. Gjithsesi, referuar nenit 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” dhe nenit 14, pika 3, e ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (*shfuqizuar neni 14 i këtij ligji, me ligjin nr. 86/2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në*

ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar), vlerësojmë se vëllai i subjektit nuk mbarte detyrimin për deklarim.

22.56.5. Nisur nga arsyetimi i mësipërm, por edhe nga vetëdeklarimi i subjektit në përgjigjet e dërguara pranë këtij Komisioni, nga ana jonë, për efekt të analizës financiare që do të kryhet për vitin përkatës, nuk do të konsiderohen të ardhurat e deklaruar si të ardhura të përfituara nga vëllai i subjektit nga puna pranë marketit "\*\*\*\*", si edhe nuk do të analizohet shtesa prej 200,000 lekësh si kursime të vëllait të subjektit, pra nuk do të merren parasysh në asnjë rast këto likuiditete si burim i krijimit të pasurisë të subjektit të rivlerësimit.

22.56.6. Për sa më sipër, konstatohet se të ardhurat e ligjshme të përfituara gjatë vitit 2010 që mund të kenë shërbyer për krijimin e pasurisë, shtesën e likuiditeteve në fund të këtij viti, janë në vlerën prej 1,312,684 lekë.

22.57. **Shpenzimet:** Nga ana e Komisionit, shpenzimet e kryera për vitin 2010 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë përllogaritur në total në shumën prej rreth 719,956 lekë.<sup>20</sup>

22.58. **Analiza e gjendjeve të llogarive:** Më datë 31.12.2010, gjendja e llogarisë rrjedhëse e subjektit në "Raiffeisen Bank" është në vlerën prej 106,850 lekë, ndërsa e bashkëshortes së subjektit është në vlerën prej 70,680 lekë. Ndërkohë, më datë 31.12.2009, gjendja e llogarisë rrjedhëse të subjektit në "Raiffeisen Bank" ishte në vlerën prej 36,428 lekë, ndërsa e bashkëshortes së tij ishte në vlerën prej 193,983 lekë.

✓ *Konstatohet se, përgjatë vitit 2010 subjekti i rivlerësimit ka pakësuar gjendjet e llogarisë rrjedhëse (të tijën dhe të bashkëshortes) në shumën prej **52,881 lekë**, vlerë e cila do të llogaritet nga ana jonë si burim për shtesën e pasurive (likuiditeteve) për vitin 2010. Por, sikurse subjekti nuk ka deklaruar si shtesë pasurie gjendjet e këtyre llogarive, po ashtu nuk ka deklaruar dhe pakësimin e tyre.*

22.59. Nga verifikimi i bërë llogarisë depozitë në emër të bashkëshortes së subjektit konstatohet se, më datë 31.12.2010, gjendja e kësaj llogarie depozitë është në vlerën prej 10.69 lekë.

✓ *Konstatohet se, subjekti ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me vlerën e shtuar të depozitës në emër të bashkëshortes së subjektit.*

22.60. **Analiza financiare vjetore:** Të dhënat e analizuara më lart, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2010, reflektohen në tabelën e mëposhtme:

**Tabela nr. 7 - Viti 2010**

Përshkrimi	Viti 2010 (Vlerat në lekë)
1. Gjendja e likuiditetit në fillim të periudhës 31.12.2009 <sup>21</sup>	3,860,378
2. Të ardhurat nga pagat/ subjekti dhe bashkëshortja	1,312,684
3. Shpenzime jetese	- 571,429

<sup>20</sup> Këto shpenzime të llogaritura përfshijnë shpenzimet minimale për konsum familjar mesatar mujor (bazuar në përbërjen e familjes sipas certifikatës familjare) dhe shpenzime për udhëtime bazuar në verifikimet e bëra në sistemin TIMS për vitin 2010.

<sup>21</sup> Përfshin kursimet cash sipas vetëdeklarimit dhe gjendjet e llogarive bankare, sipas dokumentacionit.

4. Shpenzime për udhëtime	- 148,527
5. Gjendja e likuiditetit në fund të periudhës 31.12.2010 <sup>22</sup>	4,342,435
<b>Diferenca e mbetur për shpenzime të tjera</b>	<b>110,672</b>

22.61. Për sa më sipër, konstatohet se subjekti ka burimeve financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shtesën e asetëve (*likuiditetet cash në shumën prej 400,000 lekë*) dhe shpenzimet e realizuara në vitin 2010.

#### **Analiza përmbledhëse:**

22.62. Bazuar në gjithë analizën financiare të mësipërme, të bërë veçmas për çdo vit, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e gjendjeve *cash* përgjatë viteve 2004 - 2010.

22.63. Referuar kësaj analize konstatohet se, subjekti ka pasur mundësi të kursejë sipas viteve përkatëse likuiditetet *cash* në vlerat si më poshtë:

- i. për vitin 2004, vlerën prej 257,000 lekë;
- ii. për vitin 2005, vlerën prej 95,000 lekë;
- iii. për vitin 2006, vlerën prej 355,000 lekë;
- iv. për vitin 2007, vlerën prej 260,000 lekë;
- v. për vitin 2009, vlerën prej 500,000 lekë;
- vi. për vitin 2010, vlerën prej 500,000 lekë;

- *Totali, vlera prej 1,967,000 lekë.*

22.64. Sikurse e kemi sqaruar edhe më sipër, referuar kontratës noteriale të porosisë me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 04.03.2011, të lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si të likuiduar shumën prej 20,000 euro para lidhjes së kësaj kontrate, konvertuar shuma në vlerën prej 2,800,000 lekë.

22.65. Krahas shumës prej 1,967,000 lekë, të vlerësuar nga ana jonë si shuma e mundshme e kursimeve *cash* për vitet 2004 - 2011, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e subjektit kanë pasur gjendjet e llogarive rrjedhëse, më datë 31.12.2010, në total në shumën prej 177,710 lekë.

22.66. Nga verifikimet e llogarive bankare (*të subjektit dhe bashkëshortes së subjektit*) konstatohet se deri para datës 04.03.2011, kanë tërhequr në total shumën 171,000 lekë.

22.67. Nga ana jonë u llogaritën shpenzimet minimale të jetesës për konsum familjar, referuar ILDKPKI-së, e cila bazohet në të dhënat e INSTAT-it, nga ku vlerësohet se shpenzimet për muajt janar dhe shkurt të vitit 2011, llogariten në vlerën prej 95,238 lekë.

22.68. Pra, nga tërheqjet e bëra përgjatë këtyre dy muajve, Komisioni, vlerëson se subjekti ka pasur mundësi të kursejë edhe vlerën prej **75,762 lekë**, shumë e cila do t’u shtohet të ardhurave të mundshme që kanë shërbyer si burim për kryerjen e pagesës prej 2,800,000 lekë, para datës 04.03.2011.

22.69. Gjithashtu, nga ana jonë u verifikua llogaria depozitë në “Raiffeisen Bank” në emër bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, nga ku konstatohet se, më datë 12.11.2010, nga kjo

<sup>22</sup> Përfshin kursimet *cash* sipas vetëdeklarimit dhe gjendjet e llogarive bankare, sipas dokumentacionit.

Ilogari është transferuar shuma prej 764,925 lekë, në favor të shtetases H.F.S. (e ëma e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit).

22.70. Në vazhdim të veprimeve verifikuese hetimore, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.04.2018, u jemi drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë, me qëllim evidentimin e llogarive bankare të shtetases H.F.S. dhe verifikimit të destinacionit final të shumës prej 764,925 lekë.

22.71. Pas administrimit të shkresës kthim përgjigje të “Raiffeisen Bank”, me nr. \*\*\* prot., datë 19.04.2018, me të cilën na është përcjellë llogaria e shtetases H.S., konfirmohet se, më datë 12.11.2010, llogaria e kësaj shtetaseje është kredituar me shumën prej 764,925 lekë dhe konstatohet se, më datë 14.01.2011, kjo shtetase ka tërhequr *cash* shumën prej **700,000 lekë**.

22.72. Rezulton se, rreth 3 muaj para kryerjes së pagesës për prenotimin e apartamentit, bashkëshortja e subjektit ka transferuar gjendjen e llogarisë depozitë të saj, duke e kaluar në llogarinë e nënës së saj.

### ***Analiza përfundimtare e burimit të krijimit të pasurisë, apartament***

22.73. Sikurse e kemi përshkruar edhe më sipër, në deklaratën “Vetting” (të dorëzuar pranë ILDKPKI-së), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të pasurisë (apartament) kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes së subjektit, përgjatë viteve 2004 deri 2011, në shumën prej 2,914,080 lekësh, si edhe kredinë për blerje apartamenti të disburësuar, më datë 07.06.2011, në shumën prej 2,580,000 lekë.

22.74. **Ndërsa në DPV 2011**, ka deklaruar *si burim krijimi të këtij apartamenti*: (1) kursimet në vitet 2005 - 2011 të pagës së tij, vlera 3,000,000 lekë; (2) kursimet e bashkëshortes së subjektit nga paga e saj si mësuese, depozitë në “Raiffesien Bank”, vlera 700,000 lekë; dhe (3) kredi në “BKT” në shumën 2,580,000 lekë.

22.75. Konstatohet se, në DPV 2011, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me një nga burimet e krijimit të pasurisë apartament, pasi rezulton se llogaria “depozitë bankare” në emër të bashkëshortes së subjektit, nuk ka pasur gjendje në fund të vitit 2010.

22.76. Pas pyetjes së bërë nga ana jonë lidhur me shumën prej 769,925 lekë, të transferuar më datë 12.11.2010 nga llogaria e bashkëshortes së subjektit në llogarinë e nënës së saj, si dhe destinacionin përfundimtar të saj, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka deklaruar se meqenëse në këtë periudhë bashkëshortja e tij ka mbyllur marrëdhënien e punës si mësuese në rrethin e Dibrës dhe është transferuar në Tiranë, ka mbyllur dhe llogarinë bankare, duke ia kaluar tërësisht shumën e parave mamasë së saj. Pjesa më e konsiderueshme e kësaj shume, konkretisht vlera prej 700,000 lekë është tërhequr nga nëna e bashkëshortes dhe më datë 14.01.2011 i është dorëzuar në dorë bashkëshortes së tij. Në vijim të deklaramit, subjekti ka shpjeguar se, siç e ka deklaruar edhe më parë, kjo shumë është përdorur për blerjen e apartamentit të ndodhur në Yzberisht, Tiranë, në vitin 2011. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe në prapësimet e sjella pranë këtij Komisioni si edhe në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore.

22.77. Nisur nga fakti se, lidhur me llogaritë depozitë bankare veprimet mund të kryhen në çdo filial banke,<sup>23</sup> si edhe duke qenë se bashkëshortja e subjektit ka pasur llogari rrjedhëse<sup>24</sup> në të njëjtën bankë, Komisioni vlerëson se nuk duken bindëse shpjegimet e dhëna lidhur me arsyet e transferimit të shumës së kësaj depozite në llogarinë e nënës së bashkëshortes së subjektit.

<sup>23</sup> Në këtë rast të “Raiffeisen Bank”, e cila ka disa degë në qytetin e Tiranës.

<sup>24</sup> Llogari page.

22.78. Nga sa më sipër, Komisioni vlerëson se, shuma prej 700,000 lekë, nuk ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë apartament, pasi kjo shumë është pjesë e shumës së depozitës prej 769,925 lekë, të transferuar më datë 12.11.2010 nga llogaria e bashkëshortes së subjektit në llogarinë e nënës së saj.

22.79. Nga analiza e bërë më sipër, lidhur me ligjshmërinë e burimeve financiare që kanë shërbyer për kryerjen e pagesës prej 2,800,000 lekë para datës 04.03.2011, Komisioni konstatoi se, subjekti i rivlerësimit ka pasur këto burime financiare të ligjshme të mundshme për kryerjen e kësaj pagese:

- i. vlera prej 1,967,000 lekë, si vlera e mundshme e përlllogaritur nga ana jonë, që subjekti mund të kursente likuiditete *cash* për vitet 2004 - 2010;
- ii. vlera prej 75,762 lekësh, si vlera e mundshme e përlllogaritur nga ana jonë, që subjekti mund të kursente për muajt janar - shkurt 2011.

22.80. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konfirmohet se, referuar kontratës noteriale me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, datë 31.05.2011, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e kredimarrësit ka lidhur kontratën e kredisë bankare me BKT-në. Referuar kontratës së kredisë, banka ka akorduar në favor të subjektit të rivlerësimit shumën prej 2,580,000 lekë.

22.80.1. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të përcjellë nga BKT-ja konfirmohet se shuma prej 2,580,000 lekë, e dirsburësuar në favor të subjektit të rivlerësimit, më datë 08.06.2011, është kaluar më favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “kalim në llogari për pagesë blerjeje apartamenti sipas kontratës së porosisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 04.03.2011”.

22.81 Për sa më sipër, Komisioni arrin në konkluzionin se, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shtesën e këtij aseti (*apartament*). Konkretisht, nuk justifikon plotësisht me burime pagesën e kryer për shlyerjen e këstit të parë për blerjen e këtij apartamenti.

### **23. Pasuria, llogari bankare në “Credins Bank”, e krijuar, më datë 28.10.2016, në shumën prej 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë) lekë.** Pjesa në përqindje: 50 %.

23.1. **Burimi i krijimit të pasurisë në deklaratën “Vetting”:** Si burim të krijimit janë deklaruar kursimet nga paga për vitet 2012 deri 2015, në shumën 2,000,000 lekë, si edhe 500,000 lekë nga shitja e automjetit, tip “Mercedes- Benz”, me targa \*\*\*, sipas kontratës noteriale me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 02.09.2016.

#### **23.2. Deklarimet e bëra për këtë pasuri në vite:**

23.2.1. **Referuar DPV 2012**, subjekti ka deklaruar kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes, shumën prej 400,000 lekë.

23.2.2. **Referuar DPV 2013**, subjekti ka deklaruar kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes, shumën prej 400,000 lekë.

23.2.3. **Referuar DPV 2014**, subjekti ka deklaruar kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes, shumën prej 500,000 lekë.

23.2.4. **Referuar DPV 2015**, subjekti ka deklaruar kursime nga paga e tij dhe e bashkëshortes, shumën prej 700,000 lekë.

23.2.5. **Referuar DPV 2016**, subjekti ka deklaruar 500,000 lekë, nga shitja e automjetit, tip “Mercedes- Benz”, me targa \*\*\*, sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 02.09.2016.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

23.3. Referuar DPV 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtesën e pasurisë në shumën prej 400,000 lekë në *cash*.

23.4. Siç e kemi evidentuar edhe më sipër, nga analiza financiare e bërë nga ana jonë ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të krijojë vlerën e plotë të likuiditeteve *cash* të deklaruara në vijimësi deri në vitin 2010 dhe se të gjitha kursimet e mundshme të krijuara janë reflektuar nga ana jonë si pagesa për blerjen e apartamentit.

23.5. Gjithashtu, referuar DPV 2011 konstatohet se, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesa likuiditetesh në *cash* për vitin përkatës.

23.6. Nga verifikimi i gjendjeve të llogarive bankare (të subjektit dhe të bashkëshortes së subjektit) konstatohet se gjendja totale e këtyre llogarive, më datë 31.12.2011, është në vlerën prej 56,262 lekë, ndërkohë që, më datë 31.12.2012, gjendja totale e këtyre llogarive është në vlerën prej 15,528 lekë, çka do të thotë se shuma prej 40,734 lekë do të llogaritet si e ardhur e mundshme për krijimin e gjendjes *cash* për vitin 2012.

23.7. Gjithashtu, referuar përgjigjes së pyetësorit të parë, sipas të cilit subjekti ka deklaruar se apartamenti tij është arreaduar në vitin 2012 me një investim modest, Komisioni i është drejtuar sërish subjektit të rivlerësimit, duke e pyetur lidhur me vlerën e përafërt të investimit për arredimin e shtëpisë së tij në këtë vit.

23.8. Lidhur me këtë pyetje subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi se deri në prill të vitit 2012 ka punuar në Prokurorinë e Rrethit Dibër dhe se, më pas, është transferuar në Tiranë. Me sa mban mend, vlerat e arredimit të apartamentit të tij janë: dhoma e gjumit 50 - 60 mijë lekë; kuzhina maksimumi 180 - 200 mijë lekë; për dhomën e vogël thotë se është arreaduar një vit më vonë dhe se ka një krevat dhe një dollap të vogël në vlerën 30 - 40 mijë lekë; tualeti siç është bërë nga firma ndërtuese, pra e gjitha nuk kalon shumën prej 300.000 (treqind mijë) lekë.

23.9. **Analiza financiare vjetore:** Të dhënat e analizuara më lart, lidhur me pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për vitin 2012, reflektohen në tabelën e mëposhtme:

**Tabela nr. 8– Viti 2012**

<b>Përshkrimi</b>	<b>Viti 2012 Vlerat në lekë</b>
1. Gjendja e likuiditetit në fillim të periudhës 31.12.2011 <sup>25</sup> ( <i>cash</i> dhe bankë)	1,306,262
2. Të ardhurat nga pagat subjekti dhe bashkëshortja	1,331,633
3. Shpenzime jetese	- 571,429
4. Shpenzime për udhëtime	- 18,164
5. Shpenzime për arredim shtëpie	- 260,000

<sup>25</sup> Përfshin kursimet *cash*, sipas vetëdeklarimit dhe gjendjet e llogarive bankare, sipas dokumentacionit.

6. Shpenzime për shlyerjen e kredisë (principal + interes)	- 226,152
7. Gjendja likuiditeti në fund periudhës 31/12/2012 ( <i>cash</i> dhe bankë) <sup>26</sup>	1,665,528
<b>Diferenca e pambuluar</b>	<b>- 109,258</b>

23.10. Për sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje dhe të dhënat e deklaruara lidhur me shpenzimet për arredim, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht shtesën në kursimet e deklaruara në DPV 2012 në vlerën prej 400,000 lekë.

23.11. Nga vlerësimi të dhënave të vetëdeklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit lidhur me shpenzimet e arredimit (të kryera në vitin 2012), nga ana e këtij Komisioni nuk krijohet bindja tej çdo dyshimi të arsyeshëm se vlerat e paraqitura nga ana e subjektit pasqyrojnë vlerat reale të arredimit, pasi nuk janë shoqëruar me dokumentacion justifikues, si preventivë apo fatura tatimore.

23.12. Sa më sipër, Komisioni, çmon se vlera e arredimit të këtij apartamenti ka qenë më e lartë dhe se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shtesën e aseteve, kursimet e deklaruara në DPV 2012 në vlerën prej 400,000 lekë.

23.13. Si përfundim, nga analiza financiare e bërë për vitin 2012, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shtesën e aseteve, likuiditetet *cash* në shumën prej 400,000 lekë.

23.14. Nga analiza financiare e bërë për vitin 2013, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shtesën e aseteve, likuiditetet *cash* në shumën prej 400,000 lekë.

23.15. Nga analiza financiare e bërë për vitin 2014, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shtesën e aseteve, likuiditetet *cash* në shumën prej 500,000 lekë.

23.16. Nga analiza financiare e bërë për vitin 2015, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shtesën e aseteve, likuiditetet *cash* në shumën prej 700,000 lekë.

23.17. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, konfirmohet se subjekti i rivlerësimit nëpërmjet kontratës, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 02.09.2016, ka shitur automjetin, tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, në shumën prej 500,000 lekë.

23.18. Nga verifikimi i llogarisë në “Credins Bank”, përcjellë pranë këtij Komisioni me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.01.2018, konfirmohet se, më datë 28.10.2016, subjekti i rivlerësimit ka depozituar shumën prej 2,000,000 lekë, me përshkrimin “kursime nga puna” dhe se po më datë 28.10.2016, ka depozituar shumën prej 500,000 lekë me përshkrimin “kont \*\*\* rep., \*\*\* kol.”.

23.19. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me burimin e krijimit të depozitës prej 2,500,000 lekë në “Credins Bank”, vetëdeklarimit lidhur me shpenzimet e arredimit dhe

<sup>26</sup> Përfshin kursimet *cash*, sipas vetëdeklarimit dhe gjendjet e llogarive bankare, sipas dokumentacionit.



*analizës financiare të bërë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk e justifikon plotësisht me burime të ligjshme krijimin e saj.*

#### **24. Hetimi i kryer, lidhur me objektin me sipërfaqe 32 m<sup>2</sup>, në truall të zënë, me sipërfaqe 450 m<sup>2</sup>, në Paskuqan, Tiranë.**

24.1. **Konstatimet e ILDKPKI-së lidhur me këtë pasuri:** ILDKPKI-ja, ka argumentuar se, nga verifikimi i kryer ka rezultuar: fshehje e vetëdeklarimit të bërë nga ana e subjektit të rivlerësimit në zyrat e ALUIZNI-t, kërkesën me nr. \*\*\*, datë 07.11.2006, për legalizimin e një objekti me sipërfaqe 32 m<sup>2</sup>, në truall të zënë, me sipërfaqe 450 m<sup>2</sup>, në Paskuqan, Tiranë. Ky aset, vlera e tij dhe vetëdeklarimi nuk janë deklaruar në asnjë nga deklaratat e interesave private ndër vite dhe as në deklaratën “Vetting”.

#### **24.2. Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri**

24.2.1. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.01.2018, i jemi drejtuar Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale (në vijim ALUIZNI), Drejtorisë Kamëz - Vorë, duke i kërkuar dosjen e plotë, të dhënë për legalizimin e objektit pa leje, me adresë në Paskuqan, për të cilin subjekti i rivlerësimit ka aplikuar nëpërmjet formularit nr. \*\*\* prot, datë 07.11.2006.

24.2.2. Pas administrimit të shkresës “kthim përgjigje” me nr. \*\*\* prot., datë 22.01.2018, ALUIZNI-t, Drejtoria Kamëz – Vorë, na informon se: Shtetasi, Ramadan D. Troci, ka vetëdeklaruar për legalizim objekti informal me formularin e vetëdeklarimit, nr. \*\*\* prot., datë 07.11.2006, me adresë, Paskuqan, nr. \*\*\*, Vreshtë, Njësia Administrative Paskuqan, Bashkia Kamëz, por se kjo praktikë nuk është trajtuar dhe ndodhet në fazë përgatitore.

24.2.3. Gjithashtu, lidhur me informacionin e kërkuar nga ana jonë, mbi faktin nëse ka ndryshim në vetëdeklarimin, jemi informuar se nuk ka ndryshime në vetëdeklarimin nr. \*\*\* prot., datë 07.11.2006. Nga verifikimet e kryera nga ALUIZNI nuk rezulton të ketë pasur ndonjë kërkesë të subjekteve për të kaluar të drejtën e legalizimit nga aplikuesi te persona të tjerë.

24.2.4. Nga vetëdeklarimet e bëra si edhe bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje konstatohet se, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë banimi dhe se ka qenë i regjistruar në Njësinë Administrative Paskuqan \*\*\*, Tiranë, praktikisht në adresën ku ndodhet ky objekt i palegalizuar.

24.2.5. Bazuar në dokumentacionin e administruar nga ana jonë konstatohet se, subjekti ka fshehur vetëdeklarimin e bërë në zyrat e ALUIZNI-t për legalizimin e objektit informal, me sipërfaqe 32 m<sup>2</sup>, në truall të zënë me sipërfaqe 450 m<sup>2</sup>, me adresë Paskuqan nr. \*\*\*, Vreshtë, Njësia Administrative Paskuqan, Bashkia Kamëz dhe se ky aset, vlera e tij dhe vetëdeklarimi nuk janë deklaruar në asnjë nga deklaratat e interesave private ndër vite dhe as në deklaratën “Vetting”.

24.2.6. Në prapësimet e sjella pranë këtij Komisioni dhe shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ndër të tjera ka shpjeguar se: “*ky formular është plotësuar prej babait të subjektit, se objekti i deklaruar është një kasolle dhe është ndërtuar me qëllimin e vetëm për të përfituar sipërfaqen e truallit të zënë*”.

24.2.7. Në vijim subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “*babai i tij kishte një sipërfaqe prej 1000 m<sup>2</sup>, të blerë në vitin 1997 dhe se, përveç banesës së tij në këtë truall kishte ndërtuar këtë kasolle dhe e kishte paraqitur për legalizim në emrin e tij*”.

24.2.8. Lidhur me aplikimin për legalizimin e këtij objekti, subjekti rivlerësimit ka shpjeguar se: *“është vënë në dijeni vetëm në vitin 2016, kur është thirrur pranë ILDKPKI-së”*, ku thotë se ka shpjeguar mospasjen dijeni për këtë fakt dhe se nuk ka aplikuar kurrë pranë ALUIZNI-t.

24.2.9. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera ka paraqitur pranë këtij Komisioni edhe një akt ekspertimi tekniko-grafik, mbi bazën e të cilit kërkon të provojë se firma e hedhur në formularin për vetëdeklarimin, pranë ALUIZNI-t, për këtë objekt informal, nuk është e tija. Ai, me deklaratën e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit dhe në seancë dëgjimore, ka pretenduar se falsifikimi është bërë nga i ati, shtetasi D.T.

24.2.10. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë procesverbalin e datës 12.02.2016, *“mbi shpjegimet e subjektit të deklaratës të pasurive”* të mbajtur në ambientet e ILDKPKI-së, me anë të të cilit ndër të tjera kërkon të provojë se ka dhënë shpjegime lidhur me objektin në fjalë dhe formularin e aplikimit për legalizim.

24.2.11. Nisur nga fakti i mësipërm, Komisioni vëren se, megjithëse në shkurt të vitit 2016 i është evidentuar si gjetje nga ana e ILDKPKI-së, aplikimi për legalizimin e këtij objekti pa leje, subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim ligjor për tërheqjen e këtij aplikimi në emër të tij apo të ndryshimit të situatës juridike lidhur me posedimin e kësaj ndërtese dhe, për pasojë me veprimet dhe mosveprimet e tij dëshmon se kjo është pasuri e tij dhe se nuk ka hequr dorë prej saj. Megjithatë subjekti ka pasur mundësinë që të bënte një deklaratë të saktë në deklaratën *“Vetting”* të vitit 2017, por nuk e ka bërë dhe nuk arriti të jepte shpjegime dhe prova bindëse për të rrëzuar rezultatet e hetimit të Komisionit.

24.2.12. Për sa më sipër, konstatohet se **subjekti ka fshehur pasurinë, ndërtimin pa leje me sipërfaqe 32 m<sup>2</sup>, në truall të zënë me sipërfaqe 450 m<sup>2</sup>**, ndodhur në Paskuqan, Tiranë, ndërtim i cili sipas përgjigjes së ALUIZNI-t, rezulton me kërkesë vetëdeklarimi nga ana e tij më datë 07.11.2006.

***25. Hetim pasuror i kryer ndaj subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të lidhur, bazuar në të dhënat e pyetësorëve si edhe të një denoncimi të ardhur pranë këtij Komisioni.***

25.1. Pranë këtij Komisioni është administruar denoncimi me nr. \*\*\* prot., datë 15.02.2018, i cili hedh dyshime mbi pasuri të fshehura, për të cilat pretendohet se janë përfiturar në mënyrë të kundërligjshme nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe se janë regjistruar në emër të familjarëve dhe personave të afërt me të, për të cilat nga ana e Komisionit ishin kryer paraprakisht disa verifikime.

***26. Pasuria, apartament, pranë Pazarit të Ri, Tiranë***

26.1. Në përgjigjet e përcjella pranë Komisionit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.12.2017, subjekti ka deklaruar se prej vitit 2017 e në vijim banon në apartamentin e marrë me qira nga shtetasi A.Sh., sipas deklaratës noteriale, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.03.2017.

26.2. Në këtë deklaratë noteriale parashikohet se, pranë Pazarit të Ri, Tiranë, z. A.Sh., ka një apartament me sipërfaqe rreth 140 m<sup>2</sup>, të cilën e posedon me kontratë sipërmarrje pasi shoqëria *“\*\*\*\*” sh.p.k.*, që e ka ndërtuar, nuk e ka përfunduar regjistrimin e objektit në ZVRPP-në Tiranë. Këtë apartament, i cili është i mobiluar, z. A.Sh., deklaroi se ia ka lënë në përdorim subjektit të rivlerësimit me shpërbllim kundrejt vlerës prej 30,000 lekë në muaj, pasi deklaroi se vetë është emigrant jashtë vendit.

26.3. Gjithashtu, bashkëlidhur pyetësorit të dërguar pranë Komisionit, subjekti ka dorëzuar edhe kontratën e sipërmarrjes të lidhur mes shoqërisë *“\*\*\*\*” sh.p.k.*, dhe shoqërisë *“\*\*\*\*” sh.p.k.*, sipas të cilës, shoqëria *“\*\*\*\*”* impenjohet të furnizojë me dyer dhe dritare duralumini dhe materiale të

tjera për vlerën e caktuar, firmën “\*\*\*\*”, ose “\*\*\*\*” sh.p.k., ndërsa shoqëria “\*\*\*\*”, në cilësinë e sipërmarrësit me kërkesë të porositësit merr përsipër t’i shesë këtij të fundit, në bazë të faturave të furnizimit **apartamentin me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup>, në godinën pranë Pazarit të Ri**. Më tej përcaktohet se, **vlera e apartamentit është 140,000 euro, ndërsa e parkingut 20,000 euro**.

26.4. Ndërkohë, në denoncimin e përcjellë pranë Komisioni, ndër të tjera hidhen dyshime se subjekti i rivlerësimit ka në pronësi të fshehur një apartament banimi në afërsi të ish-godinës së ATSH-së, në të cilën banon aktualisht. Lidhur me këtë apartament, denoncohet se subjekti e ka arreduar në mënyrë të tillë, sa që vetëm sistemi i ngrohjes dhe ftohjes kushton mbi 70,000 euro dhe televizori kushton rreth 20,000 euro. Në vijim ankuesi, **denoncon se për posedimin e këtij apartamenti subjekti kamuflohet nga pronarët e minierave të Bulqizës**, të cilëve pretendohet se u ka mbyllur shumë dosje.

26.5. Në vijim të veprimeve verifikuese hetimore, nga ana jonë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.01.2018, i jemi drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke i kërkuar të na konfirmojë marrëdhënien midis shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.

26.6. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.04.2018, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, ndër të tjera na informon se bazuar në përgjigjet e ardhura nga këto dy shoqëri konstatohet se, midis këtyre dy shoqërive ka pasur marrëdhënie tregtare, e konkretisht shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., përgjatë muajve qershor dhe korrik të vitit 2010 i ka lëshuar 4 fatura tatimore shitjeje shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me vlerë totale me TVSH në shumën prej 3,553,200 lekë.

26.7. Gjithashtu, nga ana jonë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.04.2018, iu dërgua njoftim për paraqitje shtetasit A.Sh., me qëllim marrjen e dëshmisë së tij lidhur me marrëdhënien e qirasë, për apartamentin në afërsi të Pazarit të Ri, Tiranë.

26.8. Më datë 16.04.2018, u paraqit pranë Komisionit shtetasi A.Sh., i cili ndër të tjera deklaroi se kompania e tij (nënkuptonte shoqërinë “\*\*\*\*”) operon që prej vitit 2009 në fushën e tregtimit të dyerve dhe dritareve. Lidhur me marrëdhënien me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., deklaroi se me këtë shoqëri ka pasur një marrëdhënie biznesi, e cila nuk është mbyllur akoma. Në vijim ai ka sqaruar se, me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., ka pasur një marrëdhënie kleringu dhe se, që pas vitit 2010, nuk arrinte dot të kontaktonte me pronarin e saj. Më tej deklaroi se ka marrë një apartament nga kjo shoqëri, por pa finalizuar kontratat, sepse objekti nuk është hipotekuar dhe nuk është regjistruar. Lidhur me faturimet e bëra ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., deklaroi se ka kryer faturime ndaj kësaj shoqërie në vlerën prej rreth 3,000,000 lekë dhe se e përfitoi apartamentin prej 140 m<sup>2</sup>, për të cilin thotë se e ka mobiluar dhe arreduar familja e tij, me një vlerë rreth 30,000 euro, pasi kishte menduar t’ia linte vajzës, pasi ajo të kthehej nga Anglia.

Komisioni e pyeti z. A.Sh. nëse ky apartament është i shoqërisë “\*\*\*\*”sh.p.k apo i tij si individ, si edhe për mënyrën se si e ka përfituar atë, nisur nga fakti se faturimi ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k ka qenë shumë i ulët si edhe faktit se në kontratën e porosisë nuk është përcaktuar vendndodhja dhe planimetria e tij. Deklaruesi u shpreh se kur të përfundojë kleringu, apartamenti do bëhet në emrin e tij, pavarësisht se kontrata është me shoqërinë, dhe se gjithashtu i ka thënë pronarit të objektit që t’i japi hipotekën në mënyrë që t’i bëjë faturimin e plotë. Ai shpjegoi se në kontratën që ai kishte parë, ishte e përcaktuar vendndodhja, por pasi Komisioni i vuri në dispozicion kontratën e sipërmarrjes që dispononte, konfirmoi se ishte ajo kontrata e firmosur prej tij. Në vijim shpjegon se ky apartament është në afërsi të Pazarit të Ri, pallati i fundit në dalje tek ATSH-ja, kati i fundit. Gjithashtu deklaroi se apartamentin e ka zgjedhur vetë.

26.9. Komisioni kreu një analizë të thelluar për marrëdhënien e qirasë që subjekti i rivlerësimit ka lidhur për këtë apartament dhe rrjedhimisht edhe për posedimin e tij, nga ku konstatoi se:

- i. nuk ka të dhëna dhe dokumentacion lidhur me pronësinë e këtij apartamenti;
- ii. nuk provohet legjitimiteti i palës qiradhënëse,<sup>27</sup> pasi edhe nëse do të merrje e mirëqenë kontrata e kleringut, ky apartament do të përfitohej nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k, e cila referuar ekstraktit historik të regjistrir tregtar, aktualisht ka 3 aksionerë;
- iii. nuk ka procesverbal dorëzimi të këtij apartamenti nga shoqëria ndërtuese tek shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k apo te shtetasi A.Sh.;
- iv. në kontratën e sipërmarrjes nuk përcaktohet vendndodhja e këtij apartamenti;
- v. shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k nuk ka kryer faturime të mjaftueshme për të përfituar një apartament me sipërfaqe 140 m<sup>2</sup> i barasvlershëm me 140.000 euro (*referuar çmimit të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes*);
- vi. vlera e qirasë është dukshëm më e ulët se vlera e tregut për këtë zonë;
- vii. duket i çuditshëm fakti se, pse shtetasi A.Sh. ka investuar rreth 30,000 euro për arredimin e këtij apartamenti, ndërkohë që ky send nuk gëzohet nga ana e tij apo e familjarëve të tij, si edhe nuk ka asnjë dokumentacion lidhur me pronësinë e tij.

26.10. Nisur nga të dhënat dhe indicet e mësipërme, Komisioni çmon se kjo pasuri është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, duke qenë se ai është poseduesi dhe zotëruesi i këtij apartamenti. Subjekti i rivlerësimit, z. Ramadan Troci, nuk arriti të japë shpjegime dhe prova bindëse për të rrëzuar dyshimet e ngritura nga trupi gjyqës.

### **27. Automjet, tip “Volkswagen Tiguan”, viti i prodhimit 2009**

27.1. Referuar të dhënave të përfituara nga sistemi *TIMS*, nga ana jonë u kërkuan nga DPSHTRR-ja të gjitha dosjet e mjeteve, sipas të cilave subjekti i rivlerësimit ka bërë hyrje-daljet në kufi.

27.2. I pyetur nga ana jonë, nëse ka përdorur në shtatë vitet e fundit pasuri të regjistruara në emrin e dikujt tjetër (*si automjete, shtëpi, anije, apartamente, shtëpi pushimi etj.*) në përgjigjet e përcjella pranë Komisionit, me shkresën e Prokurorisë së Përgjithshme, nr. \*\*\* prot., datë 20.12.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për këto vite, në cilësinë e Drejtuesit të Prokurorisë Vlorë ka përdorur automjetin e Prokurorisë së Përgjithshme, me targë \*\*\*, dhe se, nga muaji nëntor 2017 dhe deri në momentin e deklarimit po përdor autoveturën, me targë \*\*\*, që është në pronësi të shtetasit G.H., me të cilin deklaroi se ka lidhje shoqërie dhe krushqie. Gjithashtu, ka deklaruar se, në vitin 2011 ka përdorur (pa akt përdorimi) disa muaj një automjet tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\*, që i përkiste shtetasit E.D., kjo për faktin se për të shkuar në Prokurorinë e Rrethit Dibër ku punonte në atë kohë, udhëtonte nga Maqedonia dhe se ky automjet ishte me siguracion ndërkombëtar.

27.3. Nga verifikimi i dosjeve të mjeteve, rezultoi se mjete me targa \*\*\* (*që përputhen me inicialet dhe vitin e lindjes se subjektit të rivlerësimit, z. Ramadan Troci, datëlindja 1977*), të cilin subjekti i rivlerësimit e ka përdorur disa herë gjatë daljeve jashtë shtetit, mjet i cili në kohën që e ka përdorur figuron në pronësi të vëllait të subjektit, z. N.T., subjekti nuk e ka deklaruar kurrë.

27.4. Në vijim të verifikimit të dosjes së këtij mjeti ka rezultuar se:

- i. në policat e sigurimit për këtë mjet, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e subjektit janë shënuar si “PËRDORUES”;
  - Polica e sigurimit, nr. serie \*\*\*, periudha e sigurimit 21.04.2014 - 20.04.2015;
  - Polica e sigurimit, nr. serie \*\*\*, periudha e sigurimit 18.05.2015 - 17.05.2016;
  - Polica e sigurimit, nr. serie \*\*\*, periudha e sigurimit 24.06.2016 - 23.06.2017.

<sup>27</sup> Z. A.Sh., i cili ia ka lënë në përdorim këtë apartament.

ii. ky mjet pasi ka ndryshuar ngjyrën, ka ndryshuar targën, përfundimisht në vitin 2016, i është shitur kumatit të subjektit të rivlerësimit (*vëllait të bashkëshortes së subjektit*), duke u targuar përfundimisht, me targa \*\*\*. Konstatohet se fillimisht ky mjet ka pasur targën \*\*\*.

27.5. Subjekti është pyetur nga Komisioni nëpërmjet pyetësorit të parë në lidhje me pasuritë që ka pasur në përdorim në 7 vitet e fundit. Ai ka deklaruar se ka përdorur automjete të ndryshme, por nuk ka deklaruar kurrë përdorimin e automjetit në pronësi të shtetasit N.T.

✓ *Konstatohet se, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm pranë Komisionit, pasi nuk ka deklaruar përdorimin e automjetit \*\*\*, ndryshuar në \*\*\*. Z. Ramadan Troci, nuk arriti të japë shpjegime dhe prova bindëse për të rrëzuar dyshimet e ngritura nga trupi gjyqës.*

27.5. *Nisur nga të dhënat dhe indiciet e mësipërme, Komisioni, çmon se ky automjet është automjet i blerë nga ana e subjektit të rivlerësimit (me burime të pajustificuara) dhe është përdorur nga ana e tij, por është regjistruar fillimisht në emër të vëllait të subjektit dhe në vijim i është shitur kumatit të subjektit, me qëllim fshehjen e kësaj pasurie.*

## **28. Pasuria, ndërtesë 4-katëshe, ndodhur në Paskuqan**

28.1. Gjithashtu, në denoncimin e ardhur hidhen dyshime edhe mbi një pasuri të ndodhur në Paskuqan, Tiranë, vilë 4-katëshe, e regjistruar në emër të babait të subjektit të rivlerësimit. Denoncuesi, pretendon se babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura për të realizuar ndërtimin e kësaj vile.

28.2. Sikurse e kemi evidentuar edhe më lart, nga ana jonë, u kryhen verifikime lidhur me ndërtimin pa leje, me sipërfaqe 32 m<sup>2</sup>, në truall të zënë me sipërfaqe 450 m<sup>2</sup>, Paskuqan, Tiranë, ndërtim i cili sipas përgjigjes së ALUIZNI-t, rezulton me kërkesë vetëdeklarimi nga subjekti i rivlerësimit.

28.3. Nga verifikimi i dokumentacionit të ALUIZNI-t, rezulton se kufitar me këtë objekt, është objekti në emër të babait të subjektit, z. D.T.

28.4. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.02.2018, i jemi drejtuar Drejtorisë së ALUIZNI-t, Kamëz - Vorë, duke i kërkuar dosjen e plotë të këtij objekti.

28.5. Pas administrimit të shkresës “kthim përgjigje” të Drejtorisë së ALUIZNI-t, Kamëz - Vorë, me nr. \*\*\* prot., datë 07.02.2018, konstatohet se shtetasi D. Ramadan Troci ka vetëdeklaruar për legalizim, objekt informal, me formularin e vetëdeklarimit, nr. \*\*\* prot., datë 13.09.2006, ndodhur në, Paskuqan nr. \*\*\*, Vreshtë, Njësia Administrative Nr. \*\*\*, Paskuqan, Bashkia Kamëz.

28.6. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit konstatohet se, shtetasi D.T., ka deklaruar objektin shtëpi banimi 4-katëshe, me sipërfaqe ndërtimi 182 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe të zënë 508 m<sup>2</sup>, ku në rubrikën “**viti i ndërtimit**” ka shënuar datën **10.09.2001**. Në dokumentacionin që shoqëron dosjen, ka dorëzuar certifikatën familjare, ku në përbërje të saj është bashkëshortja e subjektit dhe dy djemtë, Q. dhe N.T. Gjithashtu, nga verifikimi i formularit konstatohet se, z. D.T. ka deklaruar si kufitar nga Jugu, z. Ramadan Troci.

28.7. Nisur nga fakti se ky objekt është deklaruar si i përfunduar në vitin 2001, si edhe duke qenë se nga ana e subjektit janë dhënë shpjegime lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, të cilat nga ana jonë duken bindëse, nuk duket të ketë dyshime lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie.

## **29. Pasuritë e regjistruara në emër të familjarëve, në pallatin e firmës “\*\*\*\*”**

29.1. Nga denoncimi i ardhur pranë Komisionit (*i cituar më lart*), hidhen dyshime për disa pasuri të ndodhura në të njëjtin objekt tek Unaza e Re, si apartamente, njësi shërbimi e garazhe, sipas të

cilit pretendohet se janë pasuri të krijuara me burime jo të ligjshme nga ana e subjektit të rivlerësimit, por që janë regjistruar në emër të familjarëve të tij.

29.2. Nisur ky denoncim si edhe nga fakti që vëllai i subjektit, z. N.T., ka ushtruar aktivitet tregtar si person fizik, me NIPT \*\*\*, në fushën e tregtimit me pakicë të artikujve ushqimorë, në adresën, Unaza e Re, Pallati i firmës “\*\*\*\*”, Kashar, Tiranë, nga ana jonë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 08.01.2018, i jemi drejtuar ZVRPP-së Tiranë, duke i kërkuar informacion të plotë lidhur me të gjitha pasuritë (*apartamente, njësi shërbimi dhe garazhe*) të regjistruara në objektin e ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në Unazën e Re, Tiranë.

29.3. Me shkresën “kthim përgjigje”, nr. \*\*\* prot., datë 09.01.2018, ZVRPP-ja Tiranë, vuri në dispozicion kopje të të gjitha kartelave të pasurive që figurojnë të hapura pranë kësaj zyre, lidhur me objektin e ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në Unazën e Re, Tiranë.

29.4. Nga verifikimi i bërë konstatohet se, në këtë objekt përveç apartamentit të blerë nga ana e subjektit të rivlerësimit, janë të regjistruara edhe disa pasuri në emër të familjarëve të tij, të pasqyruara si më poshtë:

- i. në emër të vëllait të subjektit, z. N.T., janë të regjistruara 1 apartament dhe 3 njësi shërbimi, pasuri të cilat konfirmohen edhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.02.2018, të ZVRPP-së Tiranë;
- ii. në emër të z. V.S. dhe znj. K.S. (*baxhanaku dhe kunata e subjektit*) është i regjistruar një apartament dhe një/dy garazhe;
- iii. në emër të z. R.M. dhe znj. E.M. (*baxhanaku dhe kunata e subjektit*), është e regjistruar një njësi shërbimi.

29.5. I pyetur nga Komisioni lidhur me këto pasuri duke i kërkuar të deklarojë nëse ka kontribut në krijimin e tyre, nëse i ka përdorur ato si dhe, të deklarojë edhe burimin e krijimit të këtyre pasurive, të cilat janë të regjistruara në emër të vëllait të subjektit, z. N.T., subjekti ka dhënë shpjegimet përkatëse, kryesisht duke argumentuar se njësitë tregtare dhe apartamenti në emër të tij janë blerë në periudha të ndryshme kohore dhe se si burim të krijimit të tyre janë të ardhurat nga emigracioni dhe nga aktiviteti tregtar.

29.6. Për sa i përket banesës dhe garazhit të blerë nga baxhanaku i subjektit, z. V.S., për të cilin deklaroi se e ka baxhanak prej vitit 2004 dhe se, nga viti 1997 dhe aktualisht banon në Londër, ndër të tjera ka shpjeguar se, ky shtetas ka prenotuar një banesë dhe garazh te pallati “\*\*\*\*” dhe se burimi i të ardhurave është i deklaruar në bankë, para të dërguara nga Londra në llogarinë e vjehrrës së tij, të cilat më pas janë tërhequr dhe janë dorëzuar në zyrën e noteres G.A., zyrë në të cilën janë kryer veprimet.

29.7. Në vijim të verifikimeve të bëra nga ana jonë, lidhur me njësinë tregtare (*marketin*), për të cilën shtetasi N.T. ka bërë dhe një shtesë dhe ka aplikuar dhe për legalizim, në fotot e dërguara të dosjes së aplikimit, vërehet se emri tregtar i marketit i stampuar në tabelën reklamuese, përfshin edhe emrin e vajzës së subjektit të rivlerësimit. Ky market ka qenë i regjistruar në QKB në emër të z. N.T. Aktualisht është i çregjistruar si subjekt tregtar.

29.8. Referuar pikës 14, të nenit 2 si edhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit 84/2016, Komisioni vlerëson se, vëllai i subjektit të rivlerësimit, z. N.T., bën pjesë në kategorinë e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

29.9. Nga verifikimi i llogarive bankare të shtetasit N.T., i cili sipas informacionit që Komisioni disponon, më parë ka qenë emigrant në Greqi, vërehet vetëm një kreditim llogarie, më datë 13.05.2010, me vlerën 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, i cili ka përshkrimin “të

*ardhura nga emigracioni*”. Nuk ka vetëdeklaruar të ardhura të tjera nga emigracioni. Por, vërehen disa kreditime të dyshimta të llogarive si në depozitime *cash*, kthim borxhi apo me justifikimin si të ardhura nga aktiviteti privat.

29.10. Nga të dhënat e dërguara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 02.02.2018, konstatohet se në total për vitet 2010 - 2016, fitimi i deklaruar i subjektit “\*\*\*\*”, me NIPT \*\*\*, është në vlerën prej 1,630,060 lekë, për të cilin është paguar në total për këto vite tatim fitimi i thjeshtuar, vlera prej 102,737 lekë, si rrjedhojë fitimi neto është në vlerën 1,527,323 lekë.

29.11. Ndërsa për vitin 2017, ky subjekt ka deklaruar humbje nga ushtrimi i aktivitetit, vlerën prej 2,389,864 lekë. Për sa më sipër, referuar shkresës së ardhur nga DRT-ja Tiranë, konstatohet se rezultati financiar i këtij subjekti është në vlerën -759,804 lekë.

29.12. Vërehet gjithashtu se, për pasuritë e blera (*apartamentin dhe njësitë tregtare*), shtetasi N.T., paguan një pjesë të vlerës dhe pjesën tjetër të pagesës e le për një moment të dytë (*sipas parashikimeve në kontratë*), i cili është shumë i afërt me momentin e pagesës së kështit të parë, çka na bën të ngremë dyshime të forta lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për blerjen e tyre, pasi gëzojmë se nëse do i kishte të ardhura të ligjshme me burim emigracionin apo aktivitetin tregtar, së pari do t’i kishte këto likuiditete të depozituara në bankë, dhe së dyti do bënte pagesa të menjëhershme.

29.13. Gjithsesi, me qëllim evidentimin e mundësisë së krijimit të pasurive të regjistruara në emër të personit tjetër të lidhur, vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. N.T., u krye një analizë financiare lidhur me të gjitha pasuritë e tij dokumentuara nga Komisioni, të ardhurat e njohura bazuar në dokumentacionin e administruar dhe në vetëdeklarimet e bëra nga ana e subjektit. Theksojmë se në këtë analizë, nuk janë përfshirë shpenzimet e jetesës së personit tjetër të lidhur apo shpenzime të tjera të kryera nga ana e tij.

29.14. Analiza e kryer nga Komisioni, lidhur me pasuritë dhe të ardhurat e personit tjetër të lidhur, vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. N.T., pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

**Tabela nr.9- Personi tjetër i lidhur.**

Përshkrimi	Vlerat në lekë
1. Të ardhura nga emigracioni <sup>28</sup>	2,500,000
2. Depozitë e çelur nga, D. T., 1/2 pjesë takuese, 10,000 euro <sup>29</sup>	1,225,400
3. Të ardhura nga likuidimi dhe shitja e aktivitetit tregtar <sup>30</sup>	3,997,484
4. Të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit 2010 - 2016 <sup>31</sup>	1,527,323

<sup>28</sup> Të kredituara në llogarinë bankare të tij, më datë 13.05.2010.

<sup>29</sup> sipas vetëdeklarimit të subjektit të rivlerësimit, në llogarinë e babait të tij është depozituar shuma prej 20,000 eurosh në vitin 2005, si kontribut i përbashkët i dy vëllezërve të tij Q. dhe N.T., të ardhura nga emigracioni, të cilat thotë se kanë shërbyer për blerjen e njësisë (dyqanit) në vitin 2006.

<sup>30</sup> depozituar në NBG nga N.T. më datë 11.09.2017, si të ardhura nga shitja e mallit të biznesit ushqimor që ka pasur (të cilin e ka mbyllur) dhe nga kursimet e tij gjatë viteve.

<sup>31</sup> marrë në konsideratë fitimi i gjeneruar nga subjekti tregtar për periudhën 2010-2016.

5. Pasuritë të paluajjtshme të blera:	
5.1. Apartament, me sip.106.7 m <sup>2</sup> , Yzberisht, nr. pasurie ***, vlera 6,210,000 lekë	
5.2. Njësi shërbimi, me sip. 78.9 m <sup>2</sup> , Yzberisht, nr. pasurie ***, vlera 9,231,300 lekë	
5.3. Dyqan me sip. 48.2 m <sup>2</sup> , Yzberisht, nr. pasurie ***, vlera 5,639,400 lekë	
5.4. Njësi shërbimi me sip. 63.9 m <sup>2</sup> , Yzberisht, me nr. pasurie ***, vlera 45,000 euro/ konvertuar 5,996,226 lekë	- 27,076,926
6. Blerë automjet, tip “Furgon Benz”, ***, vlera 500 euro, <sup>32</sup> në vitin 2008 dhe detyrimet doganore 261,361 lekë	- 446,135
7. Blerë automjet, tip “Volkswagen Tiguan”, në vitin 2014, vlera 13,000 euro <sup>33</sup> + detyrimet doganore 369,356 lekë	- 2,190,786
8. Shitur automjeti, tip “Volkswagen”, vlera 7,000 euro, viti 2016 <sup>34</sup>	946,890
9. Blerë automjet, tip “Peugot”, vlera 3,000 euro, viti 2016 <sup>35</sup>	- 320,000
10. Shitur automjet, tip “Peugot”, vlera 300,000 lekë, viti 2013	300,000
11. Blerë automjet, tip “Nissan”, vlera 3,000 euro, viti 2017 <sup>36</sup>	- 399,748
<b>Diferenca e pambuluar</b>	<b>- 19,936,498</b>

29.15. Nga sa më sipër, konstatohet se personi tjetër i lidhur (vëllai i subjektit të rivlerësimit) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e tij.

29.16. Subjekti i rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorëve dhe në prapësimet e sjella pranë këtij Komisioni pretendon se, vëllai i subjektit, ka pasur të ardhura të tjera nga emigracioni apo nga aktiviteti tregtar, por nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues lidhur me to. Gjithsesi nga Komisioni, për një analizë sa më të drejtë, kryesisht në favorin e subjektit të rivlerësimit, i janë llogaritur disa të ardhura të pakonfirmuara me dokumentacionin e duhur ligjor, si p.sh., të ardhurat prej 30,000 euro, të depozituara pranë NBG-së, në shtator të vitit 2017, të deklaruara si të ardhura nga shitja e mallit të biznesit të tij dhe nga kursime familjare.

29.17. Ky trup gjykues vlerëson se, argumentet dhe provat e paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse dhe të mjaftueshme për të justifikuar ligjshmërinë e burimit e krijimit të këtyre pasurive, të regjistruara në emër të vëllait të subjektit.

29.18. Gjithashtu, nisur nga denoncimi dhe nga vëzhgimi i bërë nga ana jonë në rrjetet sociale, konkretisht nga *facebook*, vërehet se dy vëllezërit e subjektit ekspozonin automjete luksoze dhe se gjithashtu reklamnin njësi tregtare apo biznese në pronësi si bar-kafe (*BAR KAFE*-\*\*\*) dhe një market.

29.19. I pyetur nga ana jonë, nëse bar “\*\*\*”, i ndodhur në Rr. “\*\*\*”, Pallati “\*\*\*” sh.p.k, Tiranë, është në pronësinë e familjarëve të tij dhe se, nëse është e mundur të deklaronte shpenzimet lidhur

<sup>32</sup> konvertuar në lekë bazuar në kursin e Bankës së Shqipërisë për vitin 2018.

<sup>33</sup> konvertuar në lekë bazuar në kursin e Bankës së Shqipërisë për vitin 2014.

<sup>34</sup> konvertuar në lekë bazuar në kursin e Bankës së Shqipërisë për vitin 2016.

<sup>35</sup> konvertuar në lekë bazuar në kursin e Bankës së Shqipërisë për vitin 2013.

<sup>36</sup> konvertuar në lekë bazuar në kursin e Bankës së Shqipërisë për vitin 2017.



me arredimin e tij dhe shoqërinë ku janë blerë orenditë (karrige, kolltukë, tavolina,..etj.), subjekti ka shpjeguar se ai është në pronësi të baxhanakut të subjektit, shtetasit R.M. dhe, sipas komunikimit me të, sqaron se mobilimin e këtij bari e ka bërë qiramarrësi D.L., fakt për të cilin paraqiti dy fatura tatimore me subjekt shitës mobilerinë “\*\*\*\*”, me adresë në Vlorë.

29.20. Nga verifikimet e bëra nga ana jonë, kemi evidentuar se, shtetasi R.M. (*baxhanaku i subjektit të rivlerësimit, me origjinë nga Shijaku*), ka qenë bashkaksioner me shtetasin E.D. (*shtetas për të cilin subjekti deklaruar se i ka përdorur makinën dhe se evidentohet se ka disa pasuri në pallatin “\*\*\*\*”, Tiranë*) dhe F.C., në shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k me Nipt \*\*\*\*, e cila e ushtron aktivitetin tregtar në fushën e veprimtarisë minerare, me seli në Bulqizë.

29.21. Konstatohet se, ky shtetas i ka përfituar këto aksione nëpërmjet kontratës noteriale të shitblerjes së kuotave me nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol, datë 06.12.2010, të redaktuar nga noteri I.K., nga ku ka përfituar 33 % të kuotave të kapitalit, por që në kontratë nuk përcaktohet çmimi për blerjen e tyre.

29.22. Nëpërmjet kontratës noteriale, me nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 22.11.2016, redaktuar nga notere M.Sh., shtetasi R.M. i ka dhuruar kuotat e tij shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

29.23. *Komisionit i duket i dyshimtë përfitimi i këtyre aksioneve nga shtetasi R.M., në subjektin “\*\*\*\*” sh.p.k e cila ushtron veprimtarinë minerare në minierat e Bulqizës. Në këtë kohë, subjekti i rivlerësimit ka qenë me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe se në vazhdimësi ka pasur në hetim disa çështje hetimore për konsumimin e veprës penale të “Shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë”, parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, që lidhen me aksidente të ndodhura në minierat e Bulqizës, për të cilat ai kryesisht ka vendosur mosfillimin/pushimin e procedimeve penale.*

29.24. *Dyshohet se këto aksione mund të jenë aksione të fshehura të subjektit të rivlerësimit, të regjistruara në emër të baxhanakut të tij, kjo nisur dhe nga marrëdhënia e ngushtë që subjekti ka me shtetasin E.D., aksioner dhe përfaqësues ligjor i kësaj shoqërie. z. Troci nuk arriti të japë shpjegime dhe prova bindëse për të rrëzuar dyshimet e ngritura nga trupi gjyqësor.*

### **30. Konkluzione mbi vlerësimin e pasurisë**

*30.1. Komisioni, pasi shqyrtoi dokumentacionin e grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe provat e shpjegimet e paraqitura nga subjekti, në përfundim të vlerësimit të kriterit pasuror për këtë subjekt, konstaton se:*

- 1) Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e këstit të parë, për prenotimin e apartamentit deri në vitin 2011;
- 2) Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e bërë për blerjen e automjetit në vitin 2008;
- 3) Subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e depozitës prej 2,500,000 lekë, në fund të vitit 2016;
- 4) Subjekti ka fshehur pasurinë, ndërtimin pa leje me sipërfaqe 32 m<sup>2</sup>, në truall të zënë me sipërfaqe 450 m<sup>2</sup>, në Paskuqan, Tiranë, ndërtim i cili sipas përgjigjes së ALUIZNI-t, rezulton me kërkesë vetëdeklarimi nga ana e tij më datë 07.11.2006.
- 5) Subjekti në vazhdimësi nuk ka deklaruar gjendjet e llogarive bankare, nuk ka deklaruar saktë shtesat e depozitës në emër të bashkëshortes së tij, si edhe ka kryer deklarime të pasakta lidhur me të ardhurat e përfituara.
- 6) Bazuar në indicie dhe të dhëna të rëndësishme, Komisioni, krijoi bindjen se subjekti është pronar *de facto* i disa pasurive të tjera, të listuara më sipër, të cilat janë regjistruar në emër të të afërmeve dhe familjarëve të tij.

7) Vëllai i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, nuk justifikon me burime të ligjshme pasuritë e tij.

30.2. Pra, mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit:

- ✓ *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- ✓ *ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm;*
- ✓ *ka fshehur pasurinë.*

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

31. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar raportin, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së, nr. \*\*\*, datë 13.04.2018), për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar **“Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Ramadan Troci”**. Ky raport është i deklasifikuar plotësisht.

32. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

### ***Konkluzione për vlerësimin e kontrollit të figurës***

33. Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

34. Trupi gjykues vlerëson se, subjekti i rivlerësimit, z. Ramadan Troci, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

## **C. VLERËSIMI PROFESIONAL**

35. Subjekti i rivlerësimit, z. Ramadan Troci, në periudhën 16.03.2001 - 31.08.2007, ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Bulqizë; në periudhën 01.09.2007 - 16.04.2012, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër; në periudhën 17.04.2012 - 17.02.2015, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; për periudhën 18.02.2015-31.10.2016, (prokuror) komanduar si drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë; për periudhën nga muaji nëntor i vitit 2016 - aktualisht, ushtron detyrën prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

### **C/1. Raporti i mbajtur nga grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Ramadan Troci**

36. Ky raport është përgatitur nga Prokuroria e Përgjithshme si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në kuadër të procesit për rivlerësimin kalimtar bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

37. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit; (2) të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit; (3) të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (4) 5 dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (5) të dhëna nga burimet arkivore të prokurorisë/ve.

### **Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit**

38. Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, grupi i punës në Prokurorinë e Përgjithshme ka konstatuar se, formulari paraqitet i plotë dhe i nënshkruar, pa mangësi e kundërthënie, sipas shtojcës që parashikon ligji. Nuk rezulton të ketë mangësi nga pikëpamja formale. Subjekti ka deklaruar të dhënat, duke referuar si periudhë të rivlerësimit “01.01.2014 - 31.12.2016”. Pasaktësia apo mospërputhja e të dhënave ka lidhje me faktin se, vetëm në tetor 2017, është vendosur në bashkëpunim me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit që të jepen të dhënat statistikore të subjekteve të rivlerësimit për tre vitet e fundit nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, që përkon me periudhën 08 tetor 2013 deri 08 tetor 2016, ndërkohë që, formulari i vetëdeklarimit është plotësuar nga subjekti i rivlerësimit për 3 vitet e fundit kalendarike 2014, 2015 dhe 2016).

### **Të dhënat arkivore (ankesat dhe masat disiplinore- vlerësimet)**

39. Sipas raportit, subjekti rivlerësimit nuk rezulton të ketë të dhëna për masa disiplinore dhe ankesa në burimet arkivore të sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme.

40. Pranë këtij sektori ka të dhëna për vlerësimin e punës së këtij prokurori të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 42 të ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe urdhrin nr. 221, datë 19.11.2012, “Për miratimin e rregullores për sistemin e vlerësimit të punës dhe aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”.

41. Lidhur me këtë fakt, me shkresën *“Konfidenciale”*, nr. \*\*\* prot., datë 22.01.2018, i jemi drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, duke i kërkuar të dhëna lidhur me ankesa/denoncime/kallëzime të bëra ndaj subjektit të rivlerësimit, z. Ramadan Troci, nga ku rezultoi se, ndaj këtij subjekti janë depozituar 6 ankesa pranë Prokurorisë së Përgjithshme si edhe janë regjistruar 3 kallëzime të bëra ndaj tij (*çështje të cilat janë të mosfilluara apo të pushuara nga prokuroritë përkatëse*), nga shtetas të ndryshëm.

42. Lidhur me ankesat e depozituara ndaj këtij prokurori, Prokuroria e Përgjithshme në shqyrtimin e tyre, nuk ka gjetur elementë apo indicie për nisjen e procedimit disiplinor ndaj subjektit të rivlerësimit.

### **Analiza e gjetjeve<sup>37</sup>**

43. Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga 3 (tre) grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të analizuara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

44. Konstatohet se përshkrimi i dosjeve në këtë raport është bërë nga ana e grupit të punës kryesisht të Prokurorisë.

---

<sup>37</sup> Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73 - 76 të ligjit nr.96/2016

45. Lidhur me një nga dosjet e shortuara, konkretisht kallëzimit penal, nr. \*\*\*, datë regjistrimi 08.09.2014, i cili është mosfilluar me vendimin e datës 12.11.2014, grupi i punës ka konstatuar se vendimi rezulton të jetë marrë jashtë afatit 30-ditor, i caktuar me udhëzimin nr. 241, datë 22.11.2005, i ndryshuar me udhëzimin nr. 3, datë 19.06.2012, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale” të Prokurorit të Përgjithshëm.

46. Megjithatë, nga veprimet verifikuese rezulton se, vendimmarrja e prokurorit vjen menjëherë pasi oficeri i policisë gjyqësore ka kryer verifikimet e urdhëruara dhe ka relatuar se, kallëzimi penal duhet mosfilluar. Nga aktet e dosjes dhe nga verifikimet e kryera nuk rezulton që ndaj këtij vendimi të jetë bërë ankim apo të jetë shfuqizuar nga prokurori më i lartë.

47. Raporti i grupit të punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (1) aftësitë profesionale; (2) aftësitë organizative; (3) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (4) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

#### **48. Lidhur me aftësitë profesionale**

48.1. Subjekti i rivlerësimit, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 është vlerësuar në kategorinë “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij gjatë kryerjes së detyrës si prokuror.

48.2. Sipas Raportit të hartuar nga grupi i punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme konstatohet se, subjekti i rivlerësimit, z. Ramadan Troci, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Nga analizimi i 3 dokumenteve ligjore të paraqitura prej tij si dhe në 5 dosjeve të shortuara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

48.3. Subjekti ka aftësi në arsyetimin ligjor. Në aktet e dorëzuara dhe në dosjet e shortuara për prokurorin Ramadan Troci, nga ana e grupit të punës, konstatohet mënyra e saktë e pasqyrimin të rrethanave të faktit, analiza e provave dhe ballafaqimi i tyre me bazën ligjore të aplikueshme si dhe, përpilimi i kërkimit të prokurorit në mënyrë të saktë dhe të duhur, sipas ligjit.

#### **49. Aftësitë organizative**

49.1. Subjekti i rivlerësimit, z. Ramadan Troci, për periudhën e vlerësimit, përreth dy vjet ka qenë në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, e për këtë arsye është spikatur dhe vlerësuar për aftësi shumë të mira drejtuese nga Prokurori i Përgjithshëm. Më konkretisht ka treguar aftësi të larta drejtuese, duke bërë një organizim shumë të mirë të punës në Prokurori, duke e rregulluar organizimin dhe mirëfunksionimin e punës së çdo strukture nëpërmjet urdhrave të detajuar, duke mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm ecurinë efektive të hetimeve dhe punën e secilit prokuror.

49.2. Gjithashtu, grupi i punës ka konstatuar se, subjekti ka përballuar një volum të lartë dhe kompleks në punë, me cilësi dhe shpejtësi. Ka treguar aftësi profesionale të larta, ka përfunduar në kohë të shpejtë çdo praktikë që i është ngarkuar, si dhe i ka dhënë zgjidhje në mënyrë efektive çdo problematike të konstatuar. Për shkak të eksperiencës shumëvjeçare si prokuror, ka treguar aftësi shumë të mira profesionale në procedimet penale që ndjekur, duke respektuar afatet e hetimeve, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

49.3. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet proceduralë të përpiluara janë të sakta, të strukturuara, në respektim të normave të drejtshkrimit.

#### **50. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

50.1. Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë nga ana e prokurorit është përmbushur me besnikëri disiplina dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit.

50.2. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Ramadan Troci, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

50.3. Në lidhje me vlerësimin e paanësisë për subjektin e rivlerësimit, z. Ramadan Troci, për periudhën objekt vlerësimi nuk rezulton të ketë pasur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar apo të jetë diskutuar cenim i të drejtave të pjesëmarrësve në proces apo të grupeve shoqërore të cënueshme.

## **51. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

51.1. Subjekti i rivlerësimit, z. Ramadan Troci, në periudhën e vlerësimit ka shfaqur aftësi komunikuese mjaft të mira.

51.2. Në 3 (tre) dokumentet ligjore dhe në 5 (pesë) dosjet e analizuara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e prokurorit Ramadan Troci për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Mirëpo nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Ramadan Troci, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se: subjekti është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit të treguara prej tij, pasi gjatë punës si drejtues prokurorie ka shfaqur aftësi të veçanta për sa i përket ndërtimit dhe ruajtjes së marrëdhënieve korrekte me të gjitha palët, duke ruajtur në çdo rast etikën dhe lartësuar njëkohësisht figurën dhe rolin e prokurorit. Gjithashtu ky subjekt ka spikatur në aftësitë e tij personale për të mbajtur marrëdhënie institucionale dhe korrekte me të gjitha institucionet ligjzbatuese me të cilat ka ndërvepruar, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

51.3. Tre vitet e fundit nuk ka pjesëmarrje apo trajnime në shkollën e Magjistraturës, në kushtet e pamundësisë objektive për të marrë pjesë në trajnime, për shkak të ngarkesës së lartë në punë, qoftë në pozicionin e prokurorit pranë Seksionit Task-Forcë në Prokurorinë e Tiranës, gjatë vitit 2013, qoftë në pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë Vlorë.

## **C/2. Denoncime të depozituara nga publiku, pranë Komisionit**

**Mbi denoncimet e ardhura pranë Komisionit për subjektin e rivlerësimit, z. Ramadan Troci**

**52. Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 21.11.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 22.02.2018.**

52.1. Denoncues: E.K.

52.2. Objekti i denoncimeve: Denoncon për veprime korruptive dhe zvarritje në proces në mënyrë të qëllimshme

52.3. Shtetasi E.K, ndër të tjerë denoncon edhe subjektin e rivlerësimit, z. Ramadan Troci, në atë kohë drejtues i komanduar në Prokurorinë e pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

52.4. Në denoncimin e tij, ai pretendon se prokurori i çështjes E.M., ka fshehur provat, denoncon zvarritje në proces dhe se gjithashtu këta prokurorë, përfshirë dhe subjektin e rivlerësimit, Ramadan Troci, kanë mbrojtur personat të cilat janë kallëzuar nga denoncuesi.

52.5. Konstatohet se, mbi bazën e materialit kallëzues të Drejtorisë së Policisë Vendore Vlorë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, më datë 16.12.2015, ka regjistruar

procedimin penal, nr. \*\*\*, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar në nenin 186, të Kodit Penal.

52.6. Prokurori i çështjes, pasi ka shqyrtuar kallëzimin në fjalë, më datë 15.07.2016, ka vendosur pushimin e pjesshëm të hetimeve lidhur me procedimin penal, nr. \*\*\*, të vitit 2015, përcjellë njërës prej palëve denoncuese me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.07.2016, firmosur nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e drejtuesit të kësaj Prokurorie.

**53. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2017.**

53.1. Denoncues: A.B.

53.2. Objekti i denoncimit: Denoncon për korrupsion.

53.3. Denoncohet ndër të tjerë (*gjithsej 17 subjekte rivlerësimi*), edhe subjekti i rivlerësimit, Ramadan Troci, lidhur me disa çështje civile dhe penale që ky shtetas ka pasur në shkallë të ndryshme të gjyqësorit.

53.4. Nga shqyrtimi i këtij denoncimi konstatohet se, shtetasi A.B., denoncon subjektin e rivlerësimit se ka firmosur mbylljen e hetimeve, supozuar nga ana jonë lidhur me vendime pushimi apo mosfillimi nga 3 prokurorë të ndryshëm Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, por që nuk specifikohet se çfarë vendimesh.

**54. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 11.01.2018.**

54.1. Denoncues: B. Xh.

54.2. Objekti i denoncimit: Denoncon për moskryerje të procesit të rregullt hetimor dhe dhënie vendimi të padrejtë.

54.3. Shtetasi B.Xh, ndër të tjerë denoncon dhe subjektin e rivlerësimit, z. Ramadan Troci.

54.4. Nga verifikimi i kësaj ankese konstatohet se, nga ky shtetas denoncohet prokurori i çështjes si edhe gjyqtari, për të cilët thotë se e kanë hetuar e gjykuar pa kryer hetimet përkatëse.

54.5. Denoncuesi pretendon se është akuzuar për moskryerje inventari të arkës, megjithëse nga hetimi nuk i kanë gjetur asnjë urdhër që sipas rregullores së inventarizimit të Bankës së Shqipërisë, ai të mos e ketë zbatuar.

54.6. Denoncuesi, nuk e ka shoqëruar denoncimin e tij me dokumentacion shkresor, lidhur me vendimet e marra nga ana e prokurorit në hetimin e kësaj çështjeje.

54.7. Nga përmbajtja e këtij denoncimi, vërehet se gjykata ka mbajtur të njëjtin qëndrim sipas kërkesës së prokurorit, lidhur me hetimin e kryer ndaj denoncuesit.

**55. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 16.01.2018 dhe denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 23.01.2018.**

55.1. Denoncues: B.B.

55.2. Objekti i denoncimeve: Këto janë dy denoncime të ngjashme, për të njëjtën çështje, nga ku shtetasi B.B denoncon vendime në kundërshtim me ligjin, aftësi profesionale, proces jo të rregullt ligjor bazuar në dokumente të falsifikuara, shkelje të etikës profesionale, kontrolli i figurës dhe pasurisë.

55.3. Shtetasi B. B, ndër të tjerë denoncon dhe subjektin e rivlerësimit, z. Ramadan Troci.

55.4. Denoncuesi ankohet për vendimin e pushimit të çështjes penale nr. \*\*\*, datë 28.12.2012, marrë nga subjekti i rivlerësimit. Akti nuk është bashkëngjitur denoncimit.

55.5. Por pas kësaj vendimmarrje, sipas denoncimit rezultojnë të tjerë vendime (*edhe në vitin 2017*) për të njëjtën çështje, të marrë nga të tjerë subjekte, nga të cilët është vendosur sërish pushimi i çështjes.

**56. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 20.03.2018.**

56.1. Denoncues: G.T

56.2. Objekti i denoncimit: Denoncon për shkelje procedurale të pabazuara në ligj, shpërdorim detyre, korrupsion, kontrolli i figurës.

56.3. Denoncohet ndër të tjerë (*gjithsej 50 subjekte rivlerësimi*), edhe subjekti i rivlerësimit, z. Ramadan Troci, me pretendimin se është një nga prokurorët (*në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë*) që ka planifikuar, organizuar dhe montuar fillimin e paligjshëm të ndjekjes penale të tij.

**57. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 15.05.2018.**

57.1. Denoncues: L.M.

57.2. Objekti i denoncimit: Denoncon për shkelje ligjore, procese gjyqësore dhe hetimore jo të rregullta, dhënie vendimesh në kundërshtim me ligjin dhe për qëllime përfitimi, pengim për zbardhjen e së vërtetës dhe fshehje provash.

57.3. Denoncohet ndër të tjerë (*gjithsej 21 subjekte rivlerësimi*), edhe subjekti i rivlerësimit, Ramadan Troci, me pretendimin se në cilësinë e prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, së bashku me kolegë të tjerë, ushtrojnë ndikimin e tyre duke urdhëruar prokurorët e rretheve për zvarritjen e proceseve hetimore dhe gjyqësore.

**58. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 24.05.2018.**

58.1. Denoncues: M.M.

58.2. Objekti i denoncimit: Moskryerje hetimi, shkelje ligjore, vendime abuzive.

58.3. Denoncohet ndër të tjerë (*gjithsej 7 subjekte rivlerësimi*), edhe subjekti i rivlerësimit, z. Ramadan Troci, në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

58.4. Në ankesën e tij, ai denoncon për vendimmarrje të padrejtë nga prokurori E.M (*prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë*), lidhur me vendimin e pushimit të procedimit penal nr. \*\*\*, të marrë më datë 23.06.2016, për të cilin thotë se bie në kundërshtim me vendimin e mosfillimit të procedimit penal, nr. \*\*\*, i vitit 2016, marrë më datë 26.01.2016, nga prokurja S.L., prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

58.5. Shtetasi, M. M, denoncon subjektin e rivlerësimit, z. Ramadan Troci, se ka mbyllur dosje penale, e konkretisht që lidhet me pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*.

58.6. Ndërkohë nga verifikimi i këtyre akteve, konstatohet se është i njëjti drejtues prokurorie (*subjekti i rivlerësimit z. Ramadan Troci*), që ka firmosur shkresat për njohjen edhe në rastin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal ndaj këtij shtetasi po ashtu edhe të vendimit të pushimit lidhur me procedimin penal nr. \*\*\*, i vitit 2016, i hetuar nga prokurori E.M.

**59. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 17.07.2018.**

59.1. Denoncues: M.J.

59.2. Objekti i denoncimit: Korrupsion.

59.3. Përshkrimi i denoncimit: Denoncohet subjekti i rivlerësimit, z.Ramadan Troci, me pretendimin se në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë në bashkëpunim me prokuroren F.Ç, ka kërkuar mitën prej 10,000 euro dhe e kanë marrë atë nëpërmjet avokatit A.Z., për të ndryshuar cilësimin e veprës penale për një çështje ku denoncuesi ishte në cilësinë e të pandehurit.

59.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur këtij denoncimi, rezulton se:

59.4.1. Më datë 18.05.2016, nga ana e strukturave të DPV Vlorë, ndër të tjerë është arrestuar në kushtet e flagrancës shtetasi M. J., i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

59.4.2. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, përfaqësuar në gjykim nga prokurore F.Ç, ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, vleftësimin e arrestit, caktim mase sigurimi personal “arrest me burg”, për shtetasin M. J.

59.4.3. Me vendimin e datës 21.05.2016 (nr. 169 regj. themeltar), Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka vendosur:

- Pranim pjesërisht të kërkesës.
- Vleftësimin si të ligjshëm të arrestit në flagrancë të shtetasit M. J.
- Caktimin si masë sigurimi personal ndaj shtetasit M. J, atë të “arrestit me burg” me afat 45 ditë, të parashikuar nga neni 238 të Kodit të Procedurës Penale.

59.4.4. Në vijim prokuroria, ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr.169, datë 21.05.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, caktimin e masës së sigurimit **“arrest me burg” pa afat.**

59.4.5. Me vendimin nr. 253, datë 06.06.2016, Gjykata e Apelit Vlorë, ka vendosur:

- Miratimin e vendimit nr. 169, datë 21.05.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me ndryshimin:
- Caktimin e masës së sigurimit “arrestit me burg”, ndaj të dyshuarit M. J.

59.4.6. Nga verifikimi i vendimit të gjykatës, ndër të tjera vërehet se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, **ka paraqitur kërkesën për gjykimin e procedimit penal nr. \*\*\***, të vitit 2016, ndaj të pandehurit M.J., i akuzuar se ka kryer veprën penale të **“Moskallëzimit të krimit”**, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

59.4.7. Me vendimin nr. 825 (nr. 1008 regj. themeltar), datë 17.10.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndër të tjera ka vendosur:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit M. J, për kryerjen e veprës penale “moskallëzimi i krimit” dhe në bazë të nenit 300 të Kodit Penal, e ka dënuar me 1(një) vit e 4(katër) muaj burgim.
- Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale ulet 1/3 e dënimit.
- Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i këtij të pandehuri nga I.E.P.V.P Vlorë, nëse ndaj tij nuk ka vendim tjetër dënimi me burgim ose masë sigurimi “arrest me burg”.

59.4.8. Në vijim konstatohet se, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 1008 regjistrimi, datë 23.12.2016, vetëm për sa i përket aplikimit të nenit 59, të Kodit të Procedurës Penale për të pandehurve H.H. dhe F.H.

59.4.9. Me vendimin nr. 59 (nr.1015/375 regj. themeltar), datë 02.03.2017, Gjykata e Apelit Vlorë, ka vendosur:



- Lënien në fuqi të vendimit gjyqësor penal nr. 825, datë 23.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

59.5. Nga ana jonë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.07.2018, i jemi drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë me qëllim administrimin e dosjes së këtij procedimi penal.

59.6. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.07.2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, na dërgon dosjen e plotë të këtij procedimi penal.

59.7. Referuar dokumentacionit të paraqitur në këtë ankesë dhe dokumentacionit të administruar nga ana jonë, konstatohet se denoncuesi ka pranuar fajin dhe nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit nr. 825 (nr. 1008 regj. themeltar ), datë 17.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, sipas të cilit është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “moskallëzimi i krimit”, të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

59.8. Nisur nga kërkesa e bërë nga denoncuesi, pasi u mor kontakt me të, më datë 18.07.2018, u thërrit dhe u pyet në cilësinë e dëshmitarit shtetasi M. J, i cili ndër të tjera hodhi dyshime lidhur me mitën prej 10,000 euro, të kërkuar për llogari të subjektit të rivlerësimit.

59.9. Në dëshminë e tij, ai ka shpjeguar se mita i është kërkuar nga brenda burgut nga personat e grupit që ishin akuzuar për tregtim dhe trafikim lëndësh narkotike (grup me të cilin ishte ndaluar dhe shtetasi në fjalë) me pretendimin se do ia jepnin, z. Ramadan Troci (në atë kohë drejtues i Prokurorisë Vlorë), me qëllimin për të dalë nga burgu.

59.10. Në vijim, ai sqaron se shuma prej 10,000 euro i është dhënë nga vëllai i tij, avokatit të tij, z. A.Z., siç thotë ai me qëllimin për t’ia dhënë prokurorit Ramadan Troci.

59.11. Por, denoncuesi nuk shpreh siguri nëse këtë shumë parash e ka marrë prokurori Ramadan Troci dhe gjithashtu deklaroi se vetë nuk ka pasur kontakt ndonjëherë me të.

59.12. Në asnjë rast, denoncuesi nuk paraqiti asnjë rrethanë apo provë konkrete që të lidhte dhënien e mitës karshi subjektit të rivlerësimit dhe po ashtu nuk paraqiti asnjë fakt për ndonjë shkelje procedurale të subjektit të rivlerësimit.

## **60. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 24.07.2018.**

60.1. Denoncues: R. I.

60.2. Objekti i denoncimit: Korrupsion.

60.3. Përshkrimi i denoncimit: Denoncohet subjekti i rivlerësimit, z. Ramadan Troci, me pretendimin se ka përfituar një banesë nga investitori F.K, në objektin i cili është ngritur në pronën e gjyshit të denoncuesit. Denoncuesi shpjegon se, këtë banesë e ka regjistruar në emër të baxhanakut të tij V.S. dhe motrës së bashkëshortes së tij, ashtu sikurse në emër të tyre thotë se ka regjistruar edhe disa pasuri të tjera në qytetin e Vlorës, nga ku baxhanaku i tij ka disa kontrata sipërmarrje me investitorë të ndryshëm.

60.4. Lidhur me këtë denoncim, nga ana e Komisionit është kryer hetimi pasuror lidhur me baxhanakun e subjektit të rivlerësimit dhe motrës së bashkëshortes së tij. Janë dërguar shkresa zyrtare institucioneve publike dhe private, si: ZQRPP-së, DPSHTRR-së, RNSH-së, QKB-së, ALUIZNI-t, ISSH-së, DPD-së dhe bankave dhe institucioneve financiare.

60.5. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje nuk provohet se, baxhanaku i subjektit dhe motra e gruas së tij, të përfshihen në rrethin e personave të tjerë të lidhur, në kuptim të pikës 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.

## **61. Dëshmia e datës 12.09.2018**

61.1. Më datë 12.09.2018, nga ana e Komisionit, u pyet në cilësinë e dëshmitarit shtetasi A. H, në prezencën e avokatit të tij z. I.T.

61.2. Në deklarin e tij ai shpjegoi se, ka qenë i akuzuar dhe hetuar për dy vepra penale nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Mbasi është arrestuar nga ana e kësaj Prokurorie, ai shpjegon se ka hyrë në kontakt me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet personave të tretë. Ai thotë se, personat e tretë (sekserët) i kanë kërkuar një shumë parash me qëllim që nga ana e prokurorisë të akuzohej vetëm për një vepër penale dhe se të kërkohej dënimi me gjobë dhe me shërbim prove. Gjithashtu deklaroi se, duke qenë se nuk ka pasur gjendje likuiditetesh, ka rënë dakord që t'i japi një pasuri të paluajtshme (meqenëse ishte ndërtesa), apartament, për të cilin thotë se është ndërruar dy herë, pasi thotë se kërkesat e tyre u rritën.

61.3. Denoncuesi, deklaroi se është i sigurt që kjo pasuri është kërkuar në formën e mitës, nga ana e prokurorit Ramadan Troci, pasi ai ka qenë prezent në një takim të shkurtër, ku ka parë bashkë sekserët dhe prokurorin në tavolinë.

61.4. Në vijim ai deklaroi se, prokuroria kërkoi 6,5 vjet burg dënim për të dhe duke qenë se "marrëveshja" u prish, ai pretendon se i ka kërkuar kthimin mbrapsht të apartamentit dhe se personi që ka kontaktuar me të dhe në emër të të cilit është regjistruar fillimisht apartamenti, ka rënë dakord që do ia kthejë pronën, por duke i mbajtur shumën prej 10,000 eurosh si shpenzime.

61.5. Lidhur me këto fakte, denoncuesi ka paraqitur një kontratë noteriale dhurimi prone me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.03.2016, sipas të cilës pretendon se i ka dhuruar pronën e kërkuar sekserit të prokurorit Ramadan Troci.

61.6. Gjithashtu një fakt interesant që u paraqit në dëshminë e tij, është se ky shtetas është akuzuar në cilësinë e administratorit të një subjekti shoqërie tregtare, ndërkohë që nuk ka qenë i tillë në kohën e kryerjes së hetimeve.

61.7. Nga ana jonë u administrua nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë dosja e plotë që lidhet me objektin e kësaj dëshmie dhe se, nga analizimi në tërësi i saj dhe nga verifikimet e kryera nga ana jonë, nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm faktet e pretenduara nga denoncuesi.

### ***Konkluzione për vlerësimin e këtyre denoncimeve/dëshmive***

**62.** Në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisioni, vlerëson se nga analizimi në tërësi i këtyre denoncimeve/dëshmive konstatohet se ato nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Ramadan Troci.

### **C/3. Vlerësimi lidhur me disa dosje të hetuara nga subjekti i rivlerësimit**

#### **Prezantimi i çështjeve të analizuara**

**63.** Gjatë hetimit administrativ të subjektit të rivlerësimit, u verifikua puna e kryer prej tij ndër vite, ku ndër të tjera **morëm dijeni për 8 vendime**<sup>38</sup> rreth ngjarjeve me pasojë vdekjen ose

<sup>38</sup> Konkretisht (1) Vendimi i datës 08.09.2006 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Bulqizë për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. \*\*\*, të vitit 2006, (2) Vendimi i datës 10.10.2001 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Bulqizë për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal të datës 27.09.2001; (3) Vendimi i datës 26.12.2007 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. \*\*\* të vitit 2007, (4) Vendimi i datës 10.04.2008 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. \*\*, datë 08.04.2008 për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, (5) Vendimi i datës 07.12.2009 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2008, për veprën penale të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal; (6) Vendimi i

plagosjen e punonjësve në minierat e Bulqizës. Në të gjitha këto çështje, prokurori ka vendosur ose të mos fillojë ose të pushojë procedimet penale me arsyetimin se aksidentet, në çdo rast, kanë ardhur për faj të viktimave.

64. Nga verifikimi paraprak, kemi vlerësuar se, për shkak se vendimet e prokurorit janë të pamjaftueshme për të arritur në përfundime dhe i referohen thjesht një akti ekspertimi teknik, është konsideruar i nevojshëm rishqyrtimi i të gjitha dosjeve me dokumentacionin përkatës.

65. Nga 8 vendimet e dhëna nga prokurori, njëri i përket vitit 2001, ndërsa 7 të tjerët i përkasin periudhës 2006 - 2011.

66. Bazuar në pikën 4, të nenit 41, të kreut VI “*Vlerësimi i Aftësive Profesionale*”, të ligjit nr. 84/2016 “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, “*vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale. Komisioni ose Kolegji i Apelimit merr parasysh këto informacione nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit*”.

67. Me qëllim administrimin dhe analizimin e këtyre dosjeve, u kërkuan nga Prokuroria e Përgjithshme dosjet e plota të këtyre çështjeve si edhe opinion/interpretim ligjor lidhur me hapat proceduralë të hetimit dhe vendimmarrjen e prokurorit për secilën nga këto dosje.

68. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.07.2018, Prokuroria e Përgjithshme na dërgon dosjet hetimore të kërkuara, si dhe, në përmbushje të detyrave funksionale të parashikuara për organin e prokurorisë në ligjin nr. 84/2016, ka dhënë një opinion ligjor lidhur me hapat proceduralë të hetimit dhe vendimmarrjen e prokurorit.

69. Për shkak se vlerësimi i aftësisë profesionale mund të bëhet vetëm që prej vitit 2006, nga ana e Komisionit u shqyrtuan dhe u bë analiza e 7 dosjeve që i përkasin periudhës në fjalë. Komisioni si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur. Më poshtë, paraqiten gjetjet nga vlerësimi i trupit gjykues mbi këto vendime.

## **Gjetje nga analiza e dosjeve të vendimeve të mosfillimit dhe pushimit të procedimit penal**

**70. DOSJA NR. 1:** Vendimi i datës 08.09.2006 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Bulqizë për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin, nr. \*\*\*, të vitit 2006.

70.1. Me plagosjen e punonjësit S.D., në minierën e kromit Bulqizë në datë 24.08.2006, policia gjyqësore ka referuar në prokurori materialin kallëzues, më datë 28.08.2006. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se, mbështetur në aktin e ekspertizës teknike, ngjarja ka ndodhur si rrjedhojë e

---

datës 04.11.2009 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, të vitit 2009 për veprën penale të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal; (7) Vendimi i datës 20.04.2010 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* të vitit 2010 për veprën penale të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal; (8) Vendimi i datës 16.08.2011 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues nr. \*\*\* të datës 15.08.2011 për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal.

mospërbushjes së urdhrave të epërorit nga i plagosuri dhe nuk ekzistojnë elementët e veprës penale.

70.2. Për sa i përket përmbajtjes së vendimit, nga shqyrtimi në tërësi i akteve të materialit referues të policisë gjyqësore konstatohet ky vendim nuk është arsyetuar plotësisht sipas kërkesave të nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton elementët që duhet të përmbajë vendimi që zgjidh çështjen në themel.

70.3. Në këtë vendim konstatohet se, nuk janë parashtruar në mënyrë të qartë rrethanat konkrete të faktit, mënyra si ka ndodhur ky fakt, lidhja shkakësore midis veprimeve të viktimës dhe ngjarjes së ndodhur, provat mbi të cilat bazohet vendimi, duke mos i analizuar ato. Rezulton se vendimi mbështetet në rrethana fakti të paverifikuara, është marrë në mungesë të kryerjes së të gjitha veprimeve të nevojshme për të arritur në një konkluzion të drejtë mbi ekzistencën e veprës penale dhe pa ekzistuar në mënyrë të dukshme dhe të qartë rrethanat e parashikuara në nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat kushtëzojnë marrjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal.

70.4. Në momentin që prokurori ka vendosur mosfillimin e procedimit penal duket se, nuk është vërtetuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm ekzistenca e rrethanave që nuk lejonin regjistrimin e procedimit penal, pasi:

- i. Akti i ekspertimit teknik, i lëshuar nga eksperti B.B., ku mbështetet vendimi i mosfillimit të procedimit penal, nuk përmban të gjithë elementët që duhet të ketë një akt i tillë në funksion të sqarimit të rrethanave të ngjarjes dhe shkaqeve të ndodhjes së saj.
- ii. Ky akt është i paargumentuar, i paqartë dhe jobindës në përfundimet e arritura.
- iii. Përfundimet e tij mbështeten në të dhëna të paverifikuara dhe që nuk gjejnë pasqyrim në dosje. Eksperti shprehet se shkak i aksidentit ka qenë moszbatimi i urdhrat të drejtuesve të nivelit të 16-të të minierës nga i dëmtuari, por nga aktet e dosjes nuk rezulton të jetë administruar ndonjë akt që të tregojë se nga drejtuesit janë dhënë urdhra pune për të dëmtuarin dhe çfarë përfaqësojnë këto urdhra.

70.5. Nga aktet e dosjes nuk rezulton të jenë sqaruar detyrimet që ka punëdhënësi për sigurimin teknik të punonjësve dhe si janë përmbushur ato, nuk është sqaruar nëse nga punëdhënësi janë marrë masat e nevojshme të sigurimit teknik sipas Rregullores së Teknikës së Sigurimit për Minierat dhe Karrierat për shmangien e aksidenteve dhe ngjarjeve që cenojnë jetën dhe shëndetin e punonjësve.

70.6. Konstatohet se, në fashikullin e hetimit nuk është administruar asnjë akt që të vërtetojë se personi i thirrur si ekspert dhe që ka përgatitur ekspertimin teknik ka njohuri të posaçme për fushën e zbatimit të rregullave të sigurimit teknik në miniera, siç parashikon neni 179 i Kodit të Procedurës Penale. Veç kësaj, eksperti që ka hartuar aktin nuk ka përpiluar as deklaratën për ndershmëri, paanshmëri dhe ruajtje sekreti për veprimet që lidhen me ekspertimin, kërkuar nga neni 183 i Kodit të Procedurës Penale.

70.7. Materialet në dosje tregojnë se, prokurori Ramadan Troci, nuk ka deleguar dhe nuk ka kryer asnjë veprim hetimor shtesë, por është mjaftuar me veprimet hetimore paraprake të kryera nga ana e Oficerit të Policisë Gjyqësore, të Komisarariatit të Policisë Bulqizë, për të cilat vlerësojmë se janë të paplota, pasi ndër të tjera nuk janë kryer veprime hetimore apo verifikime, të cilat gjykojmë se kanë qenë të nevojshme të kryheshin, si:

- i. nuk janë evidentuar të dhënat identifikuese të personit juridik, shoqërisë në ambientet e të cilës ka ndodhur aksidenti, nuk është administruar leja minerare, leja mjedisore etj., të këtij subjekti;

- ii. prokurori ka marrë vendim pa pritje marrjen e raportit mjeko-ligjor,<sup>39</sup> i cili mund të kishte treguar një shkak tjetër plagosjeje;
- iii. nuk janë thirrur dhe pyetur përfaqësues të kësaj shoqërie, si drejtuesi teknik i minierës, apo përfaqësuesi ligjor i saj;
- iv. nuk është pyetur shtetasi i aksidentuar;
- v. raporti i ekspertimit teknik nuk bazohet në prova;
- vi. siç e theksuam edhe më sipër, nuk ka prova që tregojnë që ekspertët teknikë ishin në fakt ekspertë të asaj fushe.

70.8. Pra rezulton se, prokurori ka vendosur mosfillimin e ndjekjes penale pasi vepra penale e parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal nuk ekziston, në bazë të aktit të ekspertimit teknik që (1) thjesht shprehet se viktimë ka shkelur rregullat e sigurimit teknik; (2) nuk bazohet në prova; (3) nuk analizon detyrimet e shoqërisë dhe nëse ato janë plotësuar; (4) nuk shpjegon lidhjen shkakësore midis veprimeve të viktimës dhe ngjarjes, dhe se si mbështetet kjo në prova.

70.9. Ndodhur para këtyre rrethanave, vlerësojmë se prokurori i çështjes duhet të kishte regjistruar procedimin penal për veprën penale "Shkelja e rregullave të sigurimit në punë", parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal dhe pasi të kryeshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

**71. DOSJA NR. 2:** Vendimi i datës 26.12.2007 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. \*\*\* të vitit 2007.

71.1. Në vijim të ngjarjes së datës 14.12.2007, të ndodhur në minierën e kromit Bulqizë me pasojë vdekjen e punonjësit S.D., policia gjyqësore referoi në prokurori materialin kallëzues në datë 18.12.2007. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes vendosi mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se, mbështetur në një aktekspertim teknik, ngjarja kishte ardhur për faj të shkeljes së rregullave të sigurimit teknik nga ana e viktimës, e rrjedhimisht nuk ekzistonin elementët e veprës penale.

71.2. Për sa i përket përmbajtjes së vendimit, nga shqyrtimi në tërësi i akteve të materialit referues të policisë gjyqësore konstatohet se, ky vendim nuk është arsyetuar plotësisht sipas kërkesave të nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton elementët që duhet të përmbajë vendimi që zgjidh çështjen në themel. Në vendim nuk janë parashtruar në mënyrë të qartë të gjitha provat e administruara dhe nuk është bërë analiza e tyre.

71.3. Prokurori ka vendosur mosfillimin e procedimit penal pasi vepra penale e parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal nuk ekziston, në bazë të aktit të ekspertimit teknik që: (1) thjesht shpreh, në mënyrë të paargumentuar, se viktimë ka shkelur rregullat e sigurimit teknik; (2) nuk bazohet në prova; (3) nuk analizon detyrimet e shoqërisë dhe nëse ato janë përmbushur; (4) nuk shpjegon lidhjen shkakësore midis veprimeve të viktimës dhe ngjarjes, dhe se si kjo mbështetet në prova; (5) ka një konkluzion i cili, nga dëshmitë e përfshira në dosje, nuk përputhet me deklaratat e kolegëve të punës së viktimës.<sup>40</sup>

<sup>39</sup> i plagosuri është ekzaminuar nga eksperti mjekoligjor, më datë 14.09.2006, ndërsa raporti mjekoligjor është dërguar në prokurori më datë 29.09.2006. Të dyja këto data janë pas datës së marrjes së vendimit nga prokurori (data e vendimit 08.09.2006).

<sup>40</sup> Më datë 15.12.2007, z. B.B., përpilon aktin e ekspertizës teknike. Ky aktekspertimi, i përbërë nga 1 faqe, përcakton se viktimë ka shkelur nenet 12 pika "b" dhe nenin 57 të Rregullores së Sigurimit Teknik të cilat parashikojnë që "... punonjësit duhet të njohin kushtet e vendit të punës para fillimit të punës dhe të kontrollojnë me kujdes vendin e punës ..." dhe "... kur punonjësit arrijnë në vendin e punës, para se të fillojnë të punojnë, ata duhet të jenë të sigurt për gjendjen e duhur të vendit të punës ...". Ai vazhdon duke cituar disa artikuj të tjerë nga rregullorja. Është përmendur shkarazi se ekspertimi është i bazuar në inspektimin dhe

71.4. Pra, rezulton se, vendimi është marrë në mungesë të kryerjes së të gjitha veprimeve të nevojshme për të arritur në një konkluzion të drejtë mbi ekzistencën e veprës penale dhe pa ekzistuar në mënyrë të dukshme dhe të qartë rrethanat e parashikuara në nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat kushtëzojnë marrjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal. Zbatimi i nenit 290 i Kodit të Procedurës Penale, në të cilin mbështetet vendimi i mosfillimit kërkon ekzistencën në mënyrë të qartë dhe bindëse të rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal.

71.5. Prokurori i çështjes, z. Ramadan Troci, nuk ka deleguar dhe nuk ka kryer asnjë veprim hetimor shtesë, por është mjaftuar me veprimet hetimore paraprahe të kryera nga ana e Oficerit të Policisë Gjqësore, të Komisarariatit të Policisë Bulqizë (si p.sh., ka pasur detyrimin të verifikonte në se ky punonjës që ka ndërruar jetë në ambientet e kësaj miniere, a ka pasur një kontratë pune me subjektin në fjalë si edhe nëse ka qenë punonjës i regjistruar në organet tatimore për efekt sigurimesh shoqërore dhe shëndetësore dhe duhet të bënte sqarimin e rrethanave të dala nga hetimet paraprahe..etj.,).

71.6. Pra, konstatohet se, në momentin që prokurori ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, nuk ishte vërtetuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm ekzistenca e rrethanave që nuk lejonin regjistrimin e procedimit penal, sepse vlerësojmë se duhej të ishte bërë sqarimi i shumë rrethanave të dala nga veprimet e para, të tilla si: (1)- arsyet e korigjimeve dhe ndërhyrjeve në datat e librit të instruktazhit; (2)- arsyeve përse nuk ishin vendosur armatura provizore në vendin e ngjarjes; (3)- kontradiktave që rezultojnë mbi rrethanat e kryerjes së instruktimit dhe nëse ka qenë një proces i vërtetë apo formal; (4)- duhej të ishte bërë administrimi i urdhrat të punës që pretendohet se ka lëshuar/dhënë përgjegjësi i sektorit datën e ngjarjes; (5)- administrimi nga burime të besueshme të procesverbalit të raportit të R.I.SH.M-ve bashkë me praktikën përkatëse shoqërore të tij; (6)- pyetjes së shtetasit S.A., që ka qenë pjesë e grupit të punës.<sup>41</sup>

71.7. Konstatohet se, bazuar në nenin 179 të Kodit të Procedurës Penale, në fashikullin e hetimit nuk është administruar asnjë akt që të vërtetojë se personi i thirrur si ekspert apo që ka përgatitur ekspertimin tekniko-minerar ka pasur njohuri të posaçme për fushën e zbatimit të rregullave të teknikës së sigurimit. Veç kësaj, eksperti nuk ka përpiluar deklaratën për ndershmëri, paanshmëri dhe ruajtje sekreti për veprimet që lidhen me ekspertimin, sikurse kërkohet nga neni 183 i Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, aktiekspertimi është i paplotë, i paargumentuar dhe jo-bindës, pasi në këtë akt nuk përshkruhet dinamika e ngjarjes, në funksion të përfundimit të arritur. Akti përmban vetëm nenet e rregullores që janë shkelur nga viktimat.

71.8. Pra, nga analizimi i materialeve të dosjes rezulton se: (1) prokurori nuk ka ndërmarrë hapa në lidhje me hetimin; (2) hetimi nga oficeri i policisë gjyqësore nuk është i plotë për të përcaktuar se nuk ka baza për fillimin e procedimit penal, mungojnë elementët e nenit 289 të Kodit Penal; (3) prokurori ka marrë vendim pa pritur marrjen e raportit mjeko-ligjor i cili mund të kishte treguar një shkak tjetër plagosjeje; (4) raporti i ekspertimit-teknik nuk bazohet në prova; (5) ka mospërputhje midis konkluzionit të raportit të ekspertimit teknik dhe deklaratave të dëshmitarëve; (6) nuk ka prova që tregojnë që ekspertët teknikë ishin në fakt ekspertë të asaj fushe.

---

dokumentacionin në vend. Përfundimi është në kundërshtim me deklaratën e kolegëve të viktimës, të cilët thanë se viktimat dhe një kolegj kishin kryer kontrollin e vendit të punës. Gjithashtu, nuk arrin të shpjegojë në mënyrë të arsyeshme një lidhje shkak pasojë ndërmjet veprimeve/mosveprimeve të viktimës .

<sup>41</sup> Të gjitha këto të evidentuara në raportin e Grupit të Punës së Prokurorisë së Përgjithshme që është marrë me analizimin e këtyre dosjeve.

71.9. Ndodhur para këtyre rrethanave vlerësojmë se, prokurori çështjes duhet të kishte regjistruar procedimin penal për veprën penale “Shkelja e rregullave të sigurimit në punë”, parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal dhe pasi të kryeshin të gjitha veprimet e nevojshme hetimore të vendoste për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

**72. DOSJA NR. 3.** Vendimi i datës 10.04.2008 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal, nr. \*\*\*, datë 08.04.2008, për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal.

72.1. Vendimi i mosfillimit të procedimit penal është marrë në lidhje me materialin e referuar nga Komisarati i Policisë Bulqizë me shkresën nr. \*\*\*, datë 08.04.2008, regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër, nr. \*\*\*, datë 09.04.2008, dhe ka të bëjë me ngjarjen e ndodhur, më datë 03.04.2008, në vendin e quajtur "Liqeni i Sopeve" në zonën Thekën të Komunës Martanesh, galeria nr. \*\*\*, nën administrim të firmës "\*\*\*\*" sh.p.k., ku ka gjetur vdekjen duke punuar punonjësi kësaj firme H.K., me detyrë vagonist.

72.2. Nga analizimi i materialeve të kësaj dosjeje konstatohet se: (1) prokurori nuk ka ndërmarrë hapa në lidhje me hetimin; (2) hetimi nga oficeri i policisë gjyqësore nuk është i plotë për të përcaktuar se nuk ka baza për fillimin e procedimit penal, mungojnë elementet e nenit 289 të Kodit Penal; (3) prokurori ka marrë vendim pa pritje marrjen e raportit mjeko-ligjor i cili mund të kishte treguar një shkak tjetër plagosjeje; (4) raporti i ekspertimit teknik nuk bazohet në prova; (5) ka mospërputhje midis raportit të ekspertimit teknik dhe deklaratave të dëshmitarit; (6) nuk ka prova që tregojnë që ekspertët teknikë ishin në fakt ekspertë të asaj fushe.

72.3. Prokurori ka vendosur mosfillimin e ndjekjes penale pasi vepra penale e parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal nuk ekziston, në bazë të aktit të ekspertimit teknik që: (1) thjesht konstaton që viktima ka shkelur rregullat e sigurimit teknik; (2) nuk bazohet në prova; (3) nuk analizon detyrimet e shoqërisë dhe nëse ato janë plotësuar; (4) nuk shpjegon lidhjen shkakësore midis veprimeve të viktimës dhe ngjarjes, dhe se si mbështetet kjo në prova.

72.4. Si përfundim, nga përmbajtja e vendimit rezulton se, ky vendim mbështetet në rrethana fakti të paverifikuara, është marrë në mungesë të kryerjes së të gjitha veprimeve të nevojshme për të arritur në një konkluzion të drejtë mbi ekzistencën e veprës penale dhe pa ekzistuar në mënyrë të dukshme dhe të qartë rrethanat e parashikuara në nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale, të cilat kushtëzojnë marrjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, pasi vlerësojmë se në momentin që prokurori ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, nuk ishte vërtetuar tejet çdo dyshimi të arsyeshëm ekzistenca e rrethanave që nuk lejonin regjistrimin e procedimit.

**73. DOSJA NR. 4:** Vendimi i datës 07.12.2009 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër për pushimin e procedimit penal, nr. \*\*\*, të vitit 2008, për veprën penale të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal.

73.1. Në vijim të ngjarjes së datës 05.11.2008, të ndodhur në minierën e kromit Bulqizë me pasojë vdekjen e një punonjësi, policia gjyqësore referoi në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër materialin kallëzues për veprën penale të “Shkelje të Rregullave të Sigurisë në Punë” (neni 289 i Kodit Penal). Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes vendosi pushimin e procedimit penal me arsyetimin se, mbështetur në një aktekspertim teknik, ngjarja kishte ardhur për faj të shkeljes së rregullave të sigurimit teknik nga ana e viktimës, e rrjedhimisht nuk ekzistonin elementët e veprës penale.

73.2. Nga pikëpamja e hetimit të këtij procedimi penal konstatohet se, nuk janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore që kërkohen në kuadër të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, me qëllim sqarimin e plotë të rrethanave të faktit penal, pasojës së ardhur, shkaqeve, zbulimin e shkeljeve ligjore që kanë shkaktuar ngjarjen dhe pasojën si dhe personat përgjegjës për ngjarjen.

73.3. Nga procesverbali i mbajtur nga R.I.SH.M., më datë 05.11.2008, administruar nga oficeri i policisë gjyqësore me procesverbalin e këqyrje-marrje prove materiale, të datës 14.01.2009, konstatohet se është përcaktuar aksidenti me pasojë vdekjen e minatorit I.V., ka ndodhur si rezultat i:

- i. moszbatimit të rregullave të sigurimit teknik gjatë punës me lëndë plasëse nga ana e zjarrmëtarit K.M., dhe minatorit I.V.;
- ii. mungesës së masave organizative nga ana e personelit inxhiniero-teknik të kompanisë për vendosjen e disiplinës lidhur me zbatimin e rregullores së teknikës së sigurimit në përdorimin e lëndëve plasëse.

73.4. Ky fakt nuk është vlerësuar nga prokurori i çështjes. Në vijim, nëpërmjet këtij procesverbali, nga vlerësimi i rrethanave dhe shkaqeve të aksidentit, R.I.SH.M., ka gjykuar dhënien e disa masave administrative dhe ka lënë detyra, ndër të tjera për zotëruesin e lejes minerare (përfaqësuesin ligjor të shoqërisë) si edhe shefin e sigurimit teknik. Ndër këto masa përfshihen 5 masa disiplinore për 5 zyrtarë dhe punonjës të kompanisë, që varionin nga vërejtje deri në përjashtimin dhe heqjen e licencës. Prokurori mori në pyetje vetëm dy nga zyrtarët për të cilët R.I.SH.M. kishte rekomanduar masë disiplinore, ndërkohë në dosje gjendet një akt ku është pyetur vetëm njëri prej tyre. Nuk u krye ndonjë hetim mbi përgjegjësinë e mundshme apo marrja në pyetje e ndonjë zyrtari tjetër.

73.5. Vërehet se, nga nxjerrja e urdhrit të delegimit nga ana e prokurorit, më datë 17.11.2008, janë kryer disa veprime hetimore deri më datë 14.01.2009 (ku ndër të tjera është administruar dhe procesverbali i mësipërm) dhe, më tej, nga verifikimi i dosjes konstatohet se ka mungesë në kryerjen e veprimeve hetimore deri më datë 20.09.2009, datë në të cilën është përpiluar vendimi për ekspertimin teknik minerar. Pra, konstatohet se, për një periudhë prej afro 8-mujore, nuk është kryer asnjë veprim hetimor lidhur me këtë dosje.

73.6. Siç e konstatoam nga verifikimi i urdhrë delegimit, të datës 17.11.2008, konfirmuar kjo edhe nga procesverbali i marrjes së deklaramit, të datës 20.12.2008, administratori shoqërisë është cilësuar si person nën hetim/person ndaj të cilit zhvillohen hetime. Pra, këtij shtetasi duhet t'i ishte shënuar emri në regjistrat e njoftimit të veprave penale.

73.7. Nga verifikimi i materialeve të kësaj dosjeje konstatohet se, në kundërshtim me legjislacionin procedural penal, nuk kemi vendim për zgjatje afatesh hetimore, nga ana e këtij prokurori.

### **Ligji i zbatueshëm:**

73.8. Neni 323 i Kodit të Procedurës Penale, “*Brenda 3 muajve nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, prokurori vendos dërgimin e çështjes në gjyq ose pushimin ose pezullimin e saj*”.

73.9. Neni 324<sup>42</sup> i Kodit të Procedurës Penale, pikat 1,2 dhe 3, “*Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj...zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë*

<sup>42</sup> zgjatja e afatit (ndryshuar me ligjin nr. 8460, datë 11.02.1999, neni 3); (ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.03.2017, neni 178).



*se tre muaj...vendimi për zgjatjen e afateve të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe të dëmtuarit”.*

73.10. Gjithashtu konstatohet se, subjekti rivlerësimi ka gabuar edhe në aplikimin e dispozitës ligjore të Kodit të Procedurës Penale ku ka bazuar vendimin e pushimit për këtë dosje, pasi neni 328, pikal, germa “ë” e Kodit të Procedurës Penale, parashikon se, *“prokurori vendos pushimin e çështjes...kur i pandehuri vdes”*. Nga shqyrtimi i materialeve të kësaj dosjeje, nuk jemi në kushtet e mësipërme, për të cilat prokurori ka vendosur pushimin e këtij procedimi penal.

73.11. Pra, arsyetimi i vendimit është i paqartë. Arsyeja e përdorur për mbylljen e hetimeve (vdekja e viktimës), nuk ka kuptim, pasi viktima nuk u thirr kurrë si “i pandehur”. Bazuar në nenin 34, të Kodit të Procedurës Penale për marrjen e cilësisë së të pandehurit parashikon që... *“1. Merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilën tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. Ky akt i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij”*. Kjo nuk ka ndodhur, pasi viktima vdiq pas aksidentit. Gjithsesi, në rrethanat e dhëna, marrja në cilësinë e të pandehurit, duke i atribuuar veprën penale sipas nenit 289 të Kodit Penal (shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë), tregon se prokurori mendon se kjo dispozitë e lejon atë të ndjekë penalisht një person, i cili ka shkaktuar vdekjen e vet.

73.12. Nga analizimi i akteve të kësaj dosjeje, në mënyrë të përmblodhur konstatohet se: (1) procedimi penal ka filluar në këtë rast; (2) edhe pse ka pasur një raport të R.I.M.SH., ky raport është anashkaluar dhe nuk ka pasur hetime nga prokurori për personat (funktionarët e shoqërisë) të cilësuar si përgjegjës për aksidentin nga ky raport; (3) çështja u mbajti pezull për 8 muaj dhe më pas është urdhëruar një ekspertim i pavarur që ngre dyshime se aksidenti mund të ishte shkaktuar nga faji i viktimës; (4) nuk ka vendim të prokurorit për shtyrjen e afatit të hetimit sipas nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale; (5) shtyrja e afatit të hetimit me 8 muaj duket se ka qenë pa vlerë pasi nga verifikimi i dosjes rezulton se nuk janë ndërmarrë hapa hetimorë, përveç caktimit të ekspertëve në fund të periudhës; (6) në dosje nuk janë përfshirë licenca të ekspertit dhe nuk ka indicie që ato kanë vepruar si ekspertë të betuar; (7) akti i ekspertimit nuk bazohet në prova.

73.13. Prokurori e ka marrë vendimin në bazë të aktekspertimit që: (1) është kryer nga ekspertë të cilët nuk ishin të betuar; (2) është kryer nga ekspertë kur kishte përfunduar afati i hetimit paraprak dhe nuk kishte asnjë vendim për shtyrjen e afatit; (3) sipas shkresës së Prokurorisë së Përgjithshme, më datë 27.07.2018, nuk është kryer nga ekspertë të pavarur, por punonjës të shoqërisë; (4) nuk bazohet në fakte dhe nuk shpjegon lidhjen shkakësore midis veprimeve të viktimës dhe ngjarjes.

73.14. Për sa më sipër, vlerësojmë se hetimi i kryer nga prokurori z. Ramadan Troci lidhur me këtë dosje, nuk ishte i plotë.

**74. DOSJA NR. 5:** Vendimi i datës 04.11.2009 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër për pushimin e procedimit penal, nr. \*\*\*, të vitit 2009, për veprën penale të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal.

74.1. Pas vdekjes së një punëtori më 12.02.2009 në minierën e kromit në Bulqizë (administruar nga “\*\*\*” sh.p.k.), materialet e ndjekjes penale iu referuan Prokurorisë së Rrethit Dibër nga ana e policisë gjyqësore, për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal “Shkeljen e rregullave të sigurisë në punë”, procedim penal ky i regjistruar më 14.03.2009. Subjekti i rivlerësimi më 04.11.2009 vendosi pushimin e procedimit penal me arsyetimin se, mbështetur

në një akt ekspertimi teknik, ngjarja kishte ardhur për faj të shkeljes së rregullave të sigurimit teknik nga ana e viktimës, e rrjedhimisht nuk ekzistonin elementët e veprës penale.

74.2. Pas urdhrit të datës 04.03.2009, të lëshuar nga subjekti i rivlerësimit për regjistrimin e procedimit penal, nuk ka asnjë urdhër tjetër që delegon detyra hetimore. Gjithashtu, i vetmi akt tjetër i ndodhur në dosje është ai i datës 14.09.2009, me anë të të cilit urdhërohet ekspertimi teknik dhe caktimi i ekspertëve privatë. Nga ana e prokurorit nuk rezulton të jetë kryer asnjë veprim tjetër hetimor i dokumentuar. Në dosje nuk rezulton të ketë një vendim të prokurorit për zgjatjen e hetimit sipas nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale. Akti i ekspertizës teknike u hartua më 02.11.2009, me konkluzione të paqarta se viktimë po lëvizte i shkujdesur pa qenë e nevojshme në një vend të rrezikshëm pune, e për rrjedhojë aksidenti ndodhi për faj të viktimës. Akti i ekspertizës shpjegon se ekspertët e kishin të pamundur të këqyrjen e vendit të ngjarjes, pasi kishte kaluar një kohë e gjatë dhe ata e hartuan ekspertizën bazuar mbi të dhënat e mbledhura pas aksidentit. Nuk ka shpjegime ose kërkime nëse ishte bërë më përpara kontrolli i vendit të punës. Në dosje nuk gjenden as licencat e ekspertëve dhe asnjë të dhënë se ku u bazuan ata për këtë rezultat.

74.3. Nga analizimi i materialeve të kësaj dosjeje konstatohet se, (1) ka filluar procedimi penal për këtë çështje; (2) çështja është lënë pezull për 6 muaj dhe më pas është administruar një ekspertizë e pavarur ku thuhet se aksidenti mund të jetë shkaktuar për faj të viktimës; (3) nga verifikimi i dosjes rezulton se nuk janë ndërmarrë hapa hetimorë; (4) nuk ka vendim të prokurorit për shtyrjen e afatit të hetimit sipas nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale; (5) akti i ekspertimit nuk bazohet në prova; (6) raporti mjeko-ligjor nuk është përfshirë në dosje, edhe pse ka një vendim të policisë gjyqësore për këqyrjen e vendit.

74.4. Prokurori e ka marrë vendimin në bazë të një akti ekspertimit që: (1) është kryer nga ekspertë kur kishte përfunduar afati i hetimit paraprak dhe nuk kishte asnjë vendim për shtyrjen e afatit; (2) nuk bazohet në prova dhe nuk shpjegon lidhjen shkakësore midis veprimeve të viktimës dhe ngjarjes.

74.5. Gjithashtu konstatohet se, subjekti rivlerësimit ka gabuar edhe në aplikimin e dispozitës ligjore të Kodit të Procedurës Penale ku ka bazuar vendimin e pushimit për këtë dosje, pasi neni 328, pika 1, germa “ë” e Kodit të Procedurës Penale parashikon se, “ *prokurori vendos pushimin e çështjes... kur i pandehuri vdes*”. Nga shqyrtimi i materialeve të kësaj dosjeje, nuk jemi në kushtet e mësipërme, për të cilat prokurori ka vendosur pushimin e këtij procedimi penal, pasi viktimë nuk marrë ndonjëherë cilësinë e të pandehurit.<sup>43</sup>

74.6. Arsyetimi i vendimit është i paqartë, nuk jepen shpjegime të bazuara në prova se përse duhej mbyllur hetimi.

74.7. Për sa më sipër, vlerësojmë se hetimi i kryer nga prokurori z. Ramadan Troci lidhur me këtë dosje nuk ishte i plotë.

**75. DOSJA NR. 6:** Vendimi i datës 20.04.2010 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër për pushimin e procedimit penal, nr. \*\*\*, të vitit 2010, për veprën penale të parashikuar nga neni 289/1 i Kodit Penal.

75.1. Pasi një punëtor u plagos më 10.01.2010 në minierën e kromit Bulqizë, e cila shfrytëzohej nga ACR, materiali i raportit penal u referua në Prokurorinë e Dibrës. Nga aktet e administruara në fashikullin e procedimit penal nr. \*\*\*, rezulton se procedimi penal është regjistruar në datën 25.01.2010, për veprën penale të "Shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë", të parashikuar

<sup>43</sup> Në dosje nuk ekziston ndonjë akt i komunikimit zyrtar të akuzës.

nga neni 289/1 i Kodit Penal. Procedimi është regjistruar mbi bazën e materialit referues të sjellë nga Komisariati i Policisë Bulqizë me shkresën e datës 13.01.2010, regjistruar në prokurori, më datë 14.01.2010. Pasi u krye aktekspertimi teknik, subjekti i rivlerësimit vendosi pushimin e hetimeve, duke vlerësuar se ngjarja kishte ardhur për faj të shkeljes së rregullave të sigurimit teknik nga ana e viktimës e rrjedhimisht nuk ekzistonin elementët e veprës penale.

75.2. Nga analizimi materialeve të kësaj dosjeje konstatohet se: (1) ka filluar procedimi penal; (2) raporti mjekoligjor është anashkaluar pjesërisht<sup>44</sup>; (3) hetimi nuk është i plotë pasi nuk janë marrë në pyetje funksionarët e shoqërisë, nuk është kryer hetim i thelluar për të gjetur kush duhet të mbikëqyrte punën. Në mënyrë të dyshimtë, vetëm personi i plagosur është marrë në pyetje në datën e ekspertizës teknike; (4) datat e vendimeve dhe aktet e ekspertimit janë korrigjuar, -të cilat e bëjnë rrjedhën e ngjarjeve të dyshimtë,<sup>45</sup> (5) akti i ekspertimit nuk është i plotë dhe i bazuar në prova.

75.3. Nga sa më sipër, vlerësojmë se hetimi duhej të kishte qenë më i plotë.

**76. DOSJA NR. 7:** Vendimi i datës 16.08.2011, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues, nr. \*\*\*, datë 15.08.2011, për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal.

76.1. Në vijim të ngjarjes së datës 24.06.2011, të ndodhur në minierën me subjekt “\*\*\*\*” sh.p.k., me pasojë plagosjen e një punonjësi, policia gjyqësore referoi në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër materialin kallëzues për veprën penale të “Shkelje të Rregullave të Sigurisë në Punë” (neni 289 i Kodit Penal). Subjekti i rivlerësimit vendosi mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se, mbështetur në një akt ekspertimi teknik, ngjarja kishte ardhur për faj të shkeljes së rregullave të sigurimit teknik nga vetë i plagosuri dhe se, rrjedhimisht nuk ekzistonin elementët e veprës penale.

Dosja përmban tre akte ekspertize teknike nga i njëjti ekspert (1) akti i parë daton më 23.06.2011, i hartuar mbi bazën e një vendimi të policisë gjyqësore të datës 21.06.2011 dhe përmban të dhëna mbi llojin e materialit/mineralit që mblidhej nga kompania “\*\*\*\*” sh.p.k. Të dyja këto data janë përpara se të ndodhte aksidenti në fjalë; (2) një akt i dytë ekspertimi teknik nga i njëjti ekspert daton më 24.06.2011, sipas vendimit të policisë gjyqësore më 22.06.2011 (përpara aksidentit) mbi llojin e mineraleve; (3) një akt i tretë ekspertimi teknik me gjysmë faqe ku shprehet se shkak i aksidentit është shkelja e rregullave të sigurimit teknik nga viktimja. Ndërkohë që është e pashpjegueshme se pse dy aktet e para janë pjesë e dosjes dhe për cfarë kanë shërbyer, akti i tretë nuk përmban të dhëna për materialet apo evidencat që janë marrë në konsideratë, si dhe nuk përmban shpjegime lidhur me marrëdhënien shkakësore të veprimit të viktimës me aksidentin.

76.2. Dokumentet në dosje tregojnë se vendimi bazohet në një akt ekspertize teknike që: (1) është i paqartë dhe i paarsyetuar; (2) haptazi dhe qartësisht në kundërshtim me deklaratimet e dëshmitarëve (edhe vetëm kaq duhet të mjaftonte që prokurori të kishte kryer hetime të

---

<sup>44</sup> Akti i ekspertizës mjekoligjore iu dërgua prokurorisë më datë 05.03.2010 dhe mbërriti në prokurori më 08.03.2010. Sipas këtij akti pretendohet se plagosja është e lehtë, por, për të nxjerrë një konkluzion përfundimtar, personi i plagosur duhet të ekzaminohet sërish pas 6 muajsh. Data e vendimit të prokurorit është pas datës së aktit të ekspertizës mjekoligjore, por rekomandimi i dhënë nga ana e tyre për kryerjen e një ekzaminimi të dytë pas 6 muajsh duket se nuk është marrë parasysh.

<sup>45</sup>-Vendimi i oficerit për kryerjen e ekspertizës teknike që mban datën 15.03.2010 (korrigjim me shkrim dore i datës / me shkronja shtypi është 05.03.2010); - aktekspertimi mban datën 20.03.2010 (korrigjim i datës me shkrim dore, në versionin e shtypur me shkronja shtypi është 10.03.2010).

mëtejshme); (3) i pabazuar në prova; (4) nuk analizon detyrimet e punëdhënësit dhe nëse ato janë zbatuar; (5) mungon analizimi i lidhjes shkak-pasojë midis veprimeve të viktimës dhe ngjarjes.

76.3. Rezulton se, vendimi është i paqartë dhe se mungon analiza e bazuar në prova mbi mungesën e elementëve të veprës penale parashikuar nga neni 289 i Kodit Penal, arsye për të cilën është vendosur mosfillimi i hetimit.

76.4. Nga sa më sipër, vlerësojmë se hetimi duhej të kishte qenë më i plotë.

### *Analizë ligjore lidhur me këto dosje*

#### **77. Roli i prokurorit në procedime penale dhe ndjekja penale efektive për mbrojtjen e të drejtës për jetën**

77.1. Sipas nenit 148, pika 1, të Kushtetutës, “Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit”.

77.2. Sipas nenit 24, të Kodit të Procedurës Penale, “Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq për llogari të shtetit, kryen dhe kontrollon hetimet paraprake dhe aktivitetin e policisë gjyqësore, dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr zbatimin e tyre dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja në përputhje me rregullat e parashikuara nga ky Kod.

77.3. Neni 4, paragrafi 1 dhe 2, i ligjit nr. 8737, datë 12.02.2001, “Mbi organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili ishte në fuqi në kohën e vendimeve të mësipërme, parashikonte se, “1. Prokurorët, në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës dhe ligjeve. 2. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave, interesave dhe lirive të ligjshme të njeriut.”

77.4. Udhëzimet evropiane mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë<sup>46</sup> listojnë detyrat e mëposhtme të prokurorëve:

- Prokurorët publikë gjatë të gjithë kohës dhe sipas të gjitha rrethanave do të:
  - i. ushtrojnë detyrat e tyre, duke përfshirë detyrën e ngritjes së akuzës, gjithmonë në përputhje me legjislacionin vendas dhe ndërkombëtar;
  - ii. ta ushtrojnë funksionin me drejtësi, paanshmëri, konsistencë dhe shpejtësi;
  - iii. të respektojnë, mbrojnë dhe mbështesin dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut;
  - iv. të kenë parasysh se ata po veprojnë në emër të shoqërisë dhe në interes të publikut;
  - v. të përpiqen të arrijnë një ekuilibër të drejtë midis interesave të përgjithshme të shoqërisë dhe interesave dhe të drejtave të individit.

77.5. Ndërkohë, sipas "Udhëzimeve mbi Rolin e Prokurorëve të miratuar nga Kongresi i tetë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Kriminelëve"<sup>47</sup>, parashikohet se:

- i. “11. Prokurorët duhet të kenë rol aktiv në procedimet penale, duke përfshirë edhe institucionin e ndjekjes penale, në hetimin e krimit, mbikëqyrjen e ligjshmërisë së

<sup>46</sup> <https://rm.coe.int/conference-of-prosecutors-general-of-europe-6th-session-organised-by-t/16807204b5>

<sup>47</sup> <https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/RoleOfProsecutors.aspx>

*këtyre hetimeve, mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe ushtrimin e funksioneve të tjera si përfaqësues të interesit publik.*

- ii. *12. Prokurorët, në përputhje me ligjin, kryejnë detyrat e tyre me drejtësi, në mënyrë të vazhdueshme dhe të shpejtë, respektojnë dhe mbrojnë dinjitetin njerëzor dhe mbështesin të drejtat e njeriut, duke kontribuar kështu në sigurimin e procesit të drejtë ligjor dhe funksionimin e qetë të sistemit të drejtësisë penale".*

77.6. Kushtetuta e Shqipërisë, midis të tjerash, mbron të drejtën e jetës së personit.<sup>48</sup>

77.7. E drejta e jetës së personit dhe integriteti fizik mbrohet nga **KEDNJ**, ku sipas nenit 2 të saj i detyron vendet anëtare për të mbrojtur në mënyrë aktive jetën e secilit. Ky detyrim është interpretuar nga **GJEDNJ** si "praktik dhe efektiv".<sup>49</sup>

77.8. Pjesë e kësaj mbrojtje "praktike dhe efektive" është "detyrimi procedural" i vendosur ndaj vendeve anëtare<sup>50</sup> në thelb të të cilave, gjendet detyrimi për mbajtjen e përgjegjësisë nga ana e atyre që kanë shkaktuar humbjen e jetës së tjetrit. Ky detyrim, brenda kuadrit të sistemit të drejtësisë, duhet të interpretohet si një detyrim i mjeteve dhe jo i rezultateve.<sup>51</sup> Mjetet që janë gjetur të përshtatshme për të përmbushur këtë detyrim përfshijnë mbrojtje efektive procedurale përmes procedurës gjyqësore,<sup>52</sup> ku hetimet duhet të jenë adekuate për të përcaktuar siç duhet ngjarjet dhe përgjegjësitë që i bashkëngjiten asaj.

77.9. Për të qenë "efektiv", një hetim duhet të plotësojë disa kërkesa themelore, të formuluar në praktikën gjyqësore të gjykatës sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës.<sup>53</sup> Këto kritere përfshijnë: i plotë,<sup>54</sup> i shpejtë,<sup>55</sup> i pavarur,<sup>56</sup> si dhe materialet dhe konkluzionet e hetimit duhet të jenë mjaft të arritshme për të afërmit e viktimave.<sup>57</sup>

77.10. Më konkretisht, kërkesa e "hetimit të plotë" do të thotë që autoritetet duhet gjithmonë të bëjnë një përpjekje serioze për të gjetur se çfarë ka ndodhur dhe nuk duhet të mbështeten në përfundime të nxituara ose të pabazuara për të mbyllur hetimet e tyre ose si bazë për vendimet e tyre. Ata duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshëm në dispozicion të tyre për të siguruar dëshmi lidhur me incidentin, duke përfshirë, ndër të tjera, dëshminë e dëshmitarëve okularë, dëshmi mjeko-ligjore dhe kështu me radhë. Çdo mangësi në hetim që dëmton aftësinë për të përcaktuar shkakun e lëndimeve ose identitetin e personave përgjegjës do të rrezikojë të bjerë ndesh me këtë standard.<sup>58</sup>

<sup>48</sup> neni 21 i Kushtetutës së Shqipërisë

<sup>49</sup> i.e. McCann v. UK A 324, 21 EHRR 97, para. 146, Grand Chamber; Oneryildiz v. Turkey; 41 EHRR 325 Grand Chamber

<sup>50</sup> i.e. Geppa v. Russia, 8532/06 para. 69; Anguelova v. Bulgaria, 38361/97 para 110; McCann and Others v. the United Kingdom, judgment of 27 September 1995, Series A no. 324, pp. 45-46, §§ 146-47; Salman v. Turkey [GC], no. 21986/93, § 97, ECHR 2000-VII; and Velikova v. Bulgaria, no. 41488/98, ECHR 2000-VI]

<sup>51</sup> Paul and Audrey Edwards v. the United Kingdom, no. 46477/99, § 71, ECHR 2002-II); CASE OF ŠILIH v. SLOVENIA 71463/01 para 192-193].

<sup>52</sup> i.e. Henriques Pereira v. Luxemburg 60255/00, para 56-57.

<sup>53</sup> Case of Finogenov and others v. Russia 18299/03 27311/03 para.s 268-272.

<sup>54</sup> shih Assenov and Others v. Bulgaria, 28 October 1998, §§ 103 et seq., Reports 1998-VIII; see also, mutatis mutandis, Salman v. Turkey, cited above, § 106, ECHR 2000-VII; Tanrikulu v. Turkey [GC], no. 23763/94, §§ 104 et seq., ECHR 1999-IV; and Gül v. Turkey, no. 22676/93, § 89, 14 December 2000.

<sup>55</sup> shih Labita v. Italy [GC], no. 26772/95, §§ 133 et seq., ECHR 2000-IV; Timurtaş v. Turkey cited above, § 89; Tekin v. Turkey, 9 June 1998, § 67, Reports 1998-IV; and Indelicato v. Italy, no. 31143/96, § 37, 18 October 2001.

<sup>56</sup> shih Oğur v. Turkey, [GC], no. 21954/93, §§ 91-92, ECHR 1999-III; see also Mehmet Emin Yüksel v. Turkey, no. 40154/98, § 37, 20 July 2004; and Güleç v. Turkey, 27 July 1998, §§ 80-82, Reports 1998-IV.

<sup>57</sup> shih Oğur v. Turkey [GC], no. 21594/93, § 92, ECHR 1999-III, and Khadzhaliev and Others v. Russia, no. 3013/04, § 106, 6 November 2008.

<sup>58</sup> Shih, among many authorities, Mikheyev v. Russia, no. 77617/01, §§ 107 et seq., 26 January 2006, and Assenov and Others v. Bulgaria, 28 October 1998, Reports 1998-VIII, §§ 102 et seq.

## **78. Kuadri i vlerësimit të aftësive profesionale të prokurorit**

78.1. Neni Ç, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se, "Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij Aneksi dhe ligjit.

78.2. Neni E i Aneksit të Kushtetutës parashikon:

1. *Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen një rivlerësimi të aftësisë profesionale, me qëllim identifikimin e atyre, të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit.*
2. *Vlerësimi i aftësisë për prokurorët përfshin aftësinë e prokurorit për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj.*
3. *Në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të cekëta, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij, atëherë kjo konsiderohet mangësi profesionale dhe zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të pezullimit, shoqëruar me detyrimin për të ndjekur programin e edukimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.*
4. *Në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të papërshtatshme, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe mangësia e vërejtur nuk mund të korrigjohet përmes programit njëvjeçar të edukimit, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.*
5. *Në rast se subjekti i rivlerësimit kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij, ose rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime, ose një model pune aq të dobët sa që rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve, ai konsiderohet i papërshtatshëm për të ushtruar funksionin. Në këtë rast zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.*

78.3. Sipas nenit 40 të ligjit nr. 84/2016 "Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve".

78.4. Sipas nenit 42, paragrafi 1, të ligjit nr. 84/2016 "1. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve."

78.5. Sipas nenit 43, paragrafi 1, të ligjit nr. 84/2016 "1. Procedura e vlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm."

78.6. Ligji nr. 96/2016, "Për Statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", përcakton "niveлин profesional të prokurorit" si vijon:

- Neni 73, i këtij ligji, "Aftësitë profesionale të prokurorit", parashikon se: "1. Vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorit përfshin njohuritë ligjore dhe të arsytimit ligjor. 2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të

*marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën. 3. Aspekti i arsytimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit. 4. Vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.”*

- Në nenin 74, paragrafi 4, i njëjti ligj, përcakton "aftësitë organizative" të prokurorit si më poshtë: "... 4. Në rastin e prokurorit, aftësia e prokurorit për të kryer në mënyrë të efektshme procedura hetimore dhe procedura të tjera të sistemit të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit”.
- Ndërsa për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale,<sup>59</sup> aftësive personale dhe angazhimit profesional,<sup>60</sup> të njëjtat dispozita të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, zbatohen për të gjithë magistratët.

## **79. Një model i qartë dhe i vazhdueshëm i gjykimit të gabuar**

79.1. Siç u përmend më lart, paragrafët 3, 4 dhe 5 të nenit E, të Kushtetutës kanë të bëjnë *inter alia*, ndër të tjera, me **një “model” /mënyrë pune** - jo në përputhje me pozicionin e subjektit të rivlerësimit ose aq të dobët sa që rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve.

79.2. **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë**, kur vendosi mbi kushtetutshmërinë e ligjit nr. 84/2016 mbi kriterin e aftësisë profesionale, duke iu referuar Komisionit të Venecias *amicus curiae*, arsyetoi: “Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shih edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias).”<sup>61</sup>

79.3. **Komisioni i Venecias**, në raportin e tij *amicus curiae* për Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë, shpjegoi: “...Nga ana tjetër, nga pikëpamja e pavarësisë së gjyqësorit, Gjykata Kushtetuese mund të ketë parasysh gjithashtu rëndësinë për të siguruar, gjatë vlerësimit të aftësive profesionale (nenet 40-44 të ligjit nr. 84/2016), se mendimet juridike të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat thjesht mund të konsiderohen si "të pasakta" nga vlerësuesit, nuk bëhen bazë për rezultat negativ. Është thelbësore që vlerësimi negativ të vijë vetëm në rastet e

<sup>59</sup> Referohu nenit 75, “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>60</sup> Referohu nenit 76, “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>61</sup> Vendimi i Gjykatës Kushtetuese, nr. 2, datë 18.01.2017, paragrafi 54.

*gabimeve themelore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një model i qartë dhe i qëndrueshëm i gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë aftësie.”<sup>62</sup>*

## 80. Konkluzione

80.1. Në 7 dosjet e analizuarra më lart konstatohet se, është vendosur mosfillimi i procedimit penal ose pushimi i tij, pa hetim ose pa kryer hetime të plota. Duke vepruar, përgjithësisht, me të njëjtët ekspertë/grup ekspertësh, një konkluzion i diskutueshëm e lë fajin tek viktimat edhe pse nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur këtë përfundim. Rezulton se, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit që ka hetuar këto dosje, në disa raste ka interpretuar gabim ligjin dhe gjithashtu vendimet e marra nga ana e tij nuk janë arsyetuar plotësisht sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Penale.<sup>63</sup>

80.2. Duke pasur parasysh legjislacionin e brendshëm dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, hetimi i rasteve që kanë të bëjnë me humbjen e jetës nuk ka qenë efektiv pasi nuk plotëson kriteret e një hetimi efektiv dhe të plotë.<sup>64</sup> Për më tepër, hetimi nuk është i plotë pasi nuk rezultojnë përpjekje serioze nga prokurori për të zbuluar se çfarë ka ndodhur. Në fakt konstatohet se, është mbërritur në përfundime të nxituara të bazuara në akte të cekëta ekspertize teknike, që nuk mbështeten në prova për të mos filluar ose mbyllur hetimet dhe që kanë shërbyer si bazë e vendimeve të tij të arsyetuara në kundërshtim me ligjin. Kjo tregon mungesën e kapacitetit/aftësisë së prokurorit në aspektin e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor.<sup>65</sup>

80.3. Rezulton se, në vend që të respektoheshin parimet dhe vlerat/standardet më të larta të prokurorisë,<sup>66</sup> të cilat përfshijnë detyrimin për të ndërmarrë veprime dhe për të pasur një rol aktiv në zbulimin e së vërtetës dhe detyrimin për të respektuar, mbrojtur dhe mbështetur dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut, është shfaqur neglizhencë e vazhdueshme në një seri të qartë dhe të vazhdueshme vendimesh përgjatë viteve 2006-2011. Gjithashtu, Komisioni, vlerëson se një shpërfillje e tillë dhe neglizhim ndaj humbjes së jetëve njerëzore, nuk përputhet me rolin e prokurorit.

80.4. Për sa më sipër trupi gjykues vlerëson se, subjekti i rivlerësimit përbën një model pune aq të dobët, saqë rrezikon ose shkel të drejtat e qytetarëve.

80.5. Me këtë model pune, prokurori dështon së kryeri detyrën e tij për të respektuar, mbrojtur dhe mbështetur dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut. Prandaj, nisur nga konkluzionet e nxjerra nga analizimi i dosjeve të mësipërme, Komisioni, çmon se, pozita e subjektit duhet të konsiderohet në vështrim të nenit “E”, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili thotë: “...5. Në rast se subjekti i rivlerësimit kryen veprime për të penguar ose vështirësuar vlerësimin e tij, ose rezulton se ka njohuri, aftësi, gjykim, qëndrime, ose **një model pune aq të dobët saqë rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve**, ai konsiderohet i papërshtatshëm për të ushtruar

<sup>62</sup> Komisioni i Venecias. Opinioni Nr. 868/2016, CDL-AD (2016)036, paragrafi 35.

<sup>63</sup> Referohu pikës 2 dhe 3, të nenit 73, “Aftësitë profesionale të prokurorit”, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>64</sup> Referohu pikës 4, të nenit 74, “Aftësitë Organizative”, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>65</sup> Referohu pikës 3, të nenit 73 “Aftësitë profesionale të prokurorit”, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>66</sup> Referohu nenit 75, “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”.



*funksionin. Në këtë rast zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.”*

80.6. Në shpjegimet e tij edhe gjatë seancës dëgjimore, në lidhje me këto 7 dosje, subjekti i rivlerësimit (1) sqaroi se të njëjtat dosje janë inspektuar dhe vlerësuar më parë nga Prokuroria e Përgjithshme dhe nuk janë gjetur probleme; (2) i paraqiti trupit gjykues vlerësimet e drejtuesit të Prokurorisë së Përgjithshme në atë kohë, por nuk dha shpjegimet e tij në lidhje me gjetjet e Komisionit për secilën dosje. Në lidhje me këto shpjegime, trupi gjykues vlerëson se bazuar në Kushtetutë dhe ligjin nr. 84/2016, inspektimet e mëparshme nga ana e Prokuroria e Përgjithshme nuk përbëjnë *res judicata* për qëllimet e procesit të rivlerësimit dhe se Komisioni kryen një hetim të pavarur në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin nr. 84/2016.

## **V. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, rezulton i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale si edhe nga vlerësimi tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe të nenit 61, pika 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ramadan Troci, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Pasaçëm të Apelimit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 15.11.2018.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**GENTA Tafa (BUNGO)**

**Kryesuese**

**SUELA ZHEGU**

**Anëtare**

**PAMELA QIRKO**

**Relatore**

**OLSIDA GOXHAJ**

**Sekretare gjyqësore**